



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.legjislacioni.gov.al

Nr. 40

Datë 31 mars 2014

P Ë R M B A J T J A

| | | Faqe |
|--|---|------|
| Vendim i GJK nr. 12, datë 17.3.2014 | Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, të vendimit nr. 2907, datë 1.4.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; të vendimit nr. 1607, datë 24.11.2009 të Gjykatës së Apelit Tiranë; të vendimit nr. 00-2012-2416, datë 16.11.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi)..... | 985 |
| Vendim i GJK nr. 13, datë 17.3.2014 | Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të vendimit nr. 00-2013-5, datë 10.1.2013 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi)..... | 989 |
| Vendim i GJK nr. 15, datë 21.3.2014 | Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën, të vendimit nr. 1403, datë 18.7.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; të vendimit nr. 41, datë 10.9.2008 të Gjykatës së Apelit Vlorë; të vendimit nr. 00-2012-31, datë 19.1.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi)..... | 996 |
| Vendim i GJK nr. 16, datë 21.3.2014 | Me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 81, datë 18.6.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda një afati të arsyeshëm..... | 999 |
| Vendim i GJK nr. 17, datë 24.3.2014 | Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën, të vendimit nr. 00-2012-2676, datë 21.12.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë..... | 1003 |

VENDIM
Nr. 12, datë 17.3.2014

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

| | |
|-----------------|--------------------------------|
| Bashkim Dedja | kryetar i Gjykatës Kushtetuese |
| Vladimir Kristo | anëtar i “ “ |
| Sokol Berberi | anëtar i “ “ |
| Vitore Tusha | anëtar e “ “ |
| Altina Xhoxhaj | anëtar e “ “ |
| Fatmir Hoxha | anëtar i “ “ |
| Gani Dizdari | anëtar i “ “ |

me sekretare Blerina (Çinari) Basha, në datën 27.11.2013, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë dokumentesh çështjen nr. 47/19 Akti, që i përket:

KËRKUESE: Edlira Curis (Mema), Jorida Davidson (Mema)

SUBJEKT I INTERESUAR: Pranvera Bërdaj.

OBJEKTI: Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, i vendimit nr. 2907, datë 1.4.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; i vendimit nr. 1607, datë 24.11.2009, të Gjykatës së Apelit Tiranë; i vendimit nr. 00-2012-2416, datë 16.11.2012, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “g”, dhe 142 të Kushtetutës; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 28, 29, 30, 77 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, Gani Dizdari, shqyrtoi pretendimet e kërkueseve, të cilat kërkuan pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, që kërkoji rrëzimin e kërkesës dhe pasi e diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkeset janë trashëgimtare ligjore të trashëgimlënësit Muharrem Mema. Trashëgimlënësi me subjektin e interesuar, Pranvera Bërdaj kanë themeluar shoqërinë tregtare “Four Sisters” sh.p.k.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. 2970, datë 15.12.2006, ka vendosur lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore, duke përcaktuar si trashëgimtare ligjore të radhës së parë të trashëgimlënësit Muharrem Mema kërkeset (vajzat e tij), të cilat trashëgojnë secila nga ½ pjesë takuese të pasurisë trashëgimore.

3. Sipas legjislacionit të kohës¹, kërkeset kanë aplikuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (e cila në atë kohë administronte regjistrin tregtar) për të depozituar dëshminë e trashëgimisë.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë (gjyqtar i vetëm), me vendimin nr. 29947/1, datë 30.1.2007 (gjykimi i parë), ka vendosur “Pranimin e kërkesës; depozitimim në regjistrin tregtar të vendimit nr. 2970, datë 15.12.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; hyrjen e ortakëve të rinj në shoqëri si trashëgimtare të trashëgimlënësit Muharrem Mema duke përcaktuar: 1. Jorida Mema me 25% të kuotave; 2. Edlira Curis (Mema) me 25 % të kuotave; 3. Pranvera Bërdaj 50 % të kuotave. Ndryshimet përkatëse janë pasqyruar në regjistrin tregtar dhe organet tatimore”.

5. Mbi ankimin e subjektit të interesuar Pranvera Bërdaj, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.124, datë 13.9.2007, ka vendosur: *ndryshimin e vendimit nr. 29947/1, datë 30.1.2007, të gjyqtarit të vetëm të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë duke vendosur rrëzimin e kërkesës si të pabazuar.*

6. Mbi rekursin e kërkueseve, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2011-1338 (348), datë 30.6.2011, ka vendosur: *“Prishjen e vendimit nr. 124, datë 13.9.2007, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe pushimin e gjykimit të çështjes në Gjykatën e Apelit”.*

7. Subjekti i interesuar, në datë 12.9.2007, ka depozituar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë një kërkesëpadi me objekt: *“Pavlefshmërinë e regjistrimit të vendimit nr. 29947/1, datë 30.1.2007, të gjyqtarit të vetëm të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në skedën e regjistrimit të shoqërisë “Four Sisters” sh.p.k. Rregullimin e pasojave që i vijnë shoqërisë nga pavlefshmëria e këtij regjistrimi dhe nga vdekja e ortakut të shoqërisë (gjykimi i dytë).”*

8. Në të njëjtën kohë me gjykimin që zhvillohej në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, lidhur me pavlefshmërinë e regjistrimit të vendimit të regjistrimit të shoqërisë, Gjykata Apelit Tiranë ka dhënë vendimin nr. 124, datë 13.9.2007.

9. Gjithashtu Gjykata e Apelit Tiranë, në këtë kohë, ka marrë në shqyrtim dhe ankimin e subjektit të interesuar Pranvera Bërdaj lidhur me vendimin nr. 29947//2, datë 4.5.2007 të mbledhjes së asamblesë së ortakëve. Mbledhje e asamblesë është thirrur nga kërkeset dhe me 50% të kuotave është zgjedhur administratore e shoqërisë një prej kërkueseve, Jorida Mema.

10. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 158, datë 4.10.2007, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 29947/2, datë 14.5.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhe rrëzimin e kërkesës.

¹ Ligji nr.7667, datë 28.1.1993 “Për regjistrin tregtar dhe formalitetet, që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare”.

11. Nisur nga vendimet e mësipërme të Gjykatës së Apelit Tiranë, subjekti i interesuar Pranvera Bërdaj, në gjykimin lidhur me pavlefshmërinë e regjistrimit të vendimit nr. 29947/1, datë 30.1.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (gjyqtar i vetëm), ka hequr dorë nga pika e parë e kërkitimit (pavlefshmëria e regjistrimit të vendimit 29947/1, datë 30.1.2007).

12. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 2907, datë 1.4.2008, ka vendosur: *“pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë. Kalimin e paditëses Pranvera Bërdaj, si ortakë e vetme dhe administratore në masën 100 % të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë “Four Sisters” sh.p.k., regjistruar me vendimin nr. 29947, datë 2.7.2003, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Detyrimin e paditëses Pranvera Bërdaj t’u dorëzojë trashëgimtarëve ligjorë të radhës së parë të ortakut të vdekur Muharrem Mema, të paditurve Jorida Mema dhe Edlira Curis pjesën e pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme të krijuar nga puna e ortakut të vdekur në shoqëri që nga momenti i krijimit të saj. Pushimin e gjykimit për sa i përket pjesës ku kërkohet pavlefshmëria e regjistrimit të vendimit nr. 29947/1, datë 30.1.2007. Ligjërimin e masës për sigurimin e padisë marrë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 242 akti, datë 11.7.2007. Një kopje e këtij vendimi t’i dërgohet për regjistrim QKR Tiranë”*.

13. Mbi ankimin e kërkueseve Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1607, datë 24.11.2009, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 2907, datë 1.4.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

14. Me vendimin nr. 00-2012-2416, datë 16.11.2012, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) ka vendosur mospranimin e rekursit.

II

15. Kërkeset Edlira Curis (Mema) dhe Jorida Davidson (Mema) i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese duke pretenduar se gjykimi i çështjes në të tri shkallët e gjykimit, për sa i përket pavlefshmërisë së regjistrimit të vendimit nr. 29947/1, datë 30.1.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është bërë në kundërshtim me parimin e procesit të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42, 131, shkronja “f”, të Kushtetutës dhe të nenit 6 të KEDNJ-së. Argumentet, në mënyrë të përmbledhur, paraqiten si më poshtë:

15.1 *Është cenuar parimi i arsytimit të vendimeve.* Kërkeset kanë paraqitur kërkesë për përsëritje të hetimit gjyqësor, për të cilën Gjykata e Apelit Tiranë në fillim është shprehur se *“Gjykata e këshilluar në vend vendosi të shprehet në fund të shqyrtimit gjyqësor nëse do ta pranojë ose jo”*, ndërsa në fund të shqyrtimit gjyqësor u shpreh se *“Gjykata e këshilluar në vend vendosi ta rrëzojë kërkesën për përsëritjen e hetimit gjyqësor të bërë nga pala e paditur”*. Nga ky deklaram,

rezulton qartë se gjykata nuk i ka arsytuar shkaqet e refuzimit të përsëritjes së hetimit gjyqësor, duke mos dhënë arsyet e rrëzimit të kërkesës. Qëndrimi i Gjykatës së Apelit ka cenuar standardin për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosarsytimit të vendimeve gjyqësore. Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor është cenuar dhe nga fakti se Gjykata e Apelit Tiranë nuk i ka dhënë përgjigje një pjese të pretendimeve të kërkueseve, të ngritura në ankim, konkretisht pretendimit se gjykata e shkallës së parë ka pranuar një padi që nuk mund të ngrihet, dhe se gjykata e shkallës së parë ka tejkualuar objektin e padisë.

15.2 *Është cenuar parimi i sigurisë juridike.* Gjykata e Lartë, duke vendosur mospranimin e rekursit, ka lënë në fuqi vendime, të cilat bien në kundërshtim me njëra-tjetrën. Duke qenë se në vendimin e parë nr. 00-2011-1338 (348), datë 30.6.2011, u vendos pushimi i gjykimit të çështjes në Gjykatën e Apelit, i cili për pasojë la në fuqi vendimin nr. 29947/1, datë 30.1.2007 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, atëherë në gjykimin e dytë që përfundoi me vendimin nr. 00-2012-2416, datë 16.11.2012, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë duhet të merrte në konsideratë vendimin e tij të mëparshëm nr.00-2011-1338 (348), datë 30.6.2011, dhe vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë nr. 29947/1, që vetë Gjykata e Lartë e kishte lënë në fuqi.

15.3 *Është cenuar parimi i barazisë së armëve.* Duke mos i dhënë përgjigje kërkesës për përsëritjen e hetimit gjyqësor, Gjykata e Apelit ka cenuar edhe të drejtën e kërkueseve për të paraqitur fakte e prova si dhe për të ndërtuar mbrojtjen përballë palës kundërshtuese, duke cenuar si rrjedhojë parimin e barazisë së armëve në procesin gjyqësor, dhe duke i vënë kërkeset në pozitë të pafavorshme gjatë procesit.

15.4 *Është cenuar parimi i gjykatës së caktuar me ligj,* pasi nuk është respektuar kompetenca tokësore gjatë gjykimit. Padia që u gjykua dhe u vendos nga gjykatat e zakonshme, ka pasur për objekt vetëm *“Rregullimin e pasojave që i vijnë shoqërisë nga vdekja e ortakut”*. Në bazë të nenit 334/b të Kodit të Procedurës Civile, në kohën kur është paraqitur padia, kompetent duhet të ishte seksioni për gjykimin e mosmarrëveshjeve tregtare të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, ku e ka selinë shoqëria *“Four Sisters” sh.p.k.*

15.5 *Parimi i gjykatës së caktuar me ligj* është cenuar për shkak të mosformimit si duhet të trupit gjykues. Sipas ligjit në fuqi në kohën e ngritjes së padisë (neni 35 i KPC), paditë me vlerë mbi 10.000.000 (dhjetë milionë) lekë, duhet të gjykohen nga një trupë gjyqësore e përbërë nga tre gjyqtarë. Gjykata e Apelit Tiranë, duke mos u dhënë kërkueseve mundësinë e përsëritjes së hetimit gjyqësor, u ka mohuar mundësinë e paraqitjes së provave të reja, për të provuar pikërisht se vlera e padisë nuk është 100 000 lekë, por më shumë.

15.6 *Është cenuar parimi i disponibilitetit.* Në dispozitivin e vendimit gjykata është shprehur për caktimin e paditëses Pranvera Bërdaj si ortakë e vetme dhe administratore e shoqërisë "Four Sisters" sh.p.k, ndërkohë që ky kërkim (emërimi i administratorit) nuk figuron në kërkesëpadi dhe nuk ka qenë objekt i mosmarrëveshjes. Për më tepër, emërimi i administratorit është kompetencë e asamblesë së ortakëve dhe nuk ekziston asnjë dispozitë ligjore që emërimi i administratorit të bëhet në rrugë gjyqësore. Gjithashtu, në dispozitivin e vendimit, gjykatat kanë detyruar subjektin e interesuar t'u dorëzojë trashëgimtarëve ligjorë të radhës së parë të ortakut të vdekur Muharrem Mema, të paditurave Jorida Mema dhe Edlira Mema pjesën e pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme të krijuar nga puna e ortakut të vdekur në shoqëri, që nga momenti i krijimit të saj. Duke vendosur kështu, gjykatat kanë tejkaluar objektin e padisë sepse u kanë njohur atyre si kërkuese disa të drejta që nuk i kanë kërkuar as me padi, as me kundërpadi.

16. *Subjekti i interesuar* paraqiti prapësime me shkrim, duke argumentuar se:

16.1 *Lidhur me pretendimin për cenimin e arsytimit të vendimeve gjyqësore*, ai ka të bëjë në thelb me vlerësimin e provave, mënyrën e interpretimit të fakteve dhe zbatimin e ligjit nga ana e Gjykatës së Apelit. Gjykata nuk është e detyruar të pranojë çdo kërkesë apo provë të paraqitur nga pala. Të pabazuara janë dhe pretendimet se vendimet janë të paqarta, kanë kontradikta dhe se u mungon baza ligjore. Vendimet janë të qarta dhe kanë bërë pasqyrim të faktit që shoqëria duhet të vazhdojë aktivitetin e saj për shkak të domosdoshmërisë së kryerjes së veprimeve me shtetin dhe me të tretët.

16.2 *Lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të sigurisë juridike*, ai është i pabazuar, pasi ndodhemi jo para dy vendimeve gjyqësore, por para një vendimi të dhënë në dy faza dhe në fakt ato plotësojnë njëra-tjetrën duke zgjidhur në themel çështjen dhe duke urdhëruar regjistrimin në Regjistrin Tregtar.

16.3 *Lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të barazisë së armëve*, edhe ky është i pabazuar, pasi kërkueset janë thirrur në çdo seancë gjyqësore dhe nuk kanë pranuar të paraqiten. Gjatë gjykimit kanë pasur mundësi të paraqesin prova dhe çdo pretendim të tyre.

16.4 *Lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj*, mendojmë se ky pretendim është i pabazuar, pasi në kohën kur është zhvilluar gjykimi, regjistri tregtar mbahej nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe kompetente për të kryer veprime që lidheshin me regjistrin tregtar ishte Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Nuk qëndron as pretendimi se çështja duhej të gjykohej nga një trupë gjyqësore e përbërë prej 3 gjyqtarësh, pasi objekti i padisë nuk e

kalon vlerën prej 10 milionësh, përcaktuar nga neni 35 i KPC.

16.5 *Lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të disponibilitetit*, mendojmë se nuk qëndron, pasi gjykatat kanë rregulluar pasojat që i vijnë shoqërisë nga vdekja e ortakut, si kalimi i kuotave, dhe nuk kanë dalë tej objektit të padisë.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. *Lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të arsytimit të vendimit*

17. Kërkueset pretendojnë se Gjykata e Apelit Tiranë, duke refuzuar përsëritjen e hetimit gjyqësor, pa dhënë shkaqe të argumentuara, ka cenuar standardin për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosarsytimit të vendimit gjyqësor. Gjithashtu, kjo gjykatë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura në ankim.

18. Në jurisprudencën e saj, Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsytimit të vendimeve gjyqësore, si një garanci për procesin ligjor. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese (*shih vendimet nr. 3, datë 23.1.2014; nr. 3, datë 19.2.2013; nr. 20, datë 13.4.2012; nr. 8, datë 16.3.2011; nr. 38, datë 30.12.2010; nr. 7, datë 9.3.2009; nr. 23, datë 4.11.2008; nr. 11, datë 2.4.2008, të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsytimin e vendimeve të tyre. Ajo ka verifikuar nëse vendimi i kundërshtuar është logjik, ka kundërthënie, përmban referencat në ligjin e zbatueshëm dhe nëse respekton të gjitha elementet e sipërpërmendura. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se detyrimi për të respektuar këtë standard ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete

dhe natyrës së vendimit, dhe se masa e arsyetimit varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimin nr. 25, datë 10.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Bazuar në parashikimet e normave procedurale që përcaktojnë elementet që duhet të përmbajë një vendim gjyqësor, si dhe bazuar në veçoritë e gjykimit në Gjykatën e Lartë dhe në praktikën e saj, Gjykata çmon se në funksion të realizimit të vëzhgimit publik të administrimit të drejtësisë, si dhe të koherencës së vendimit gjyqësor, në mënyrë që përfundimi i procesit të vlerësimit të gjykatës të jetë i mbështetur, përmbajtja e vendimit përbën premisën për përmbushjen e standardit të arsyetimit të vendimit, i cili në këtë drejtim duhet të plotësojë dhe të përmbajë kriteret e përcaktuara nga dispozitat ligjore përkatëse dhe ato të zhvilluara nga jurisprudenca kushtetuese e konsoliduar (*shih vendimet nr. 3, datë 19.2.2013; nr. 36, datë 25.7.2013, të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Në çështjen konkrete, Gjykata vëren se vendimi i kundërshtuar i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, që ka vendosur mospranimin e rekursit, përmban në pjesën e tij hyrëse palët ndërgjyqëse, objektin e padisë, disponimet e gjykatave më të ulëta, si edhe shkaqet në bazë të të cilave kërkueset kanë pretenduar prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, që lidhen me shkelje procedurale, konkretisht në lidhje me gjykatën kompetente për shqyrtimin e kërkesëpadisë, përbërjen e trupit gjykues, objektin e padisë, formimin e drejtë të ndërgjyqësisë. Edhe pse këto shkaqe përfshihen në parashikimet e nenit 472 të KPC-së dhe i përkasin kompetencës së shqyrtimit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) ka vendosur mospranimin e rekursit, duke mos dhënë asnjë argument për përfundimin e shprehur në pjesën urdhëruese të vendimit.

22. Bazuar në nenin 480 të KPC-së, është në kompetencë të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) të analizojë dhe të vlerësojë nëse shkaqet e ngritura në rekurs janë në përputhje me kërkesat e ligjit. Në rast se Kolegji, në dhomën e këshillimit, krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs objektivisht nuk ekzistojnë në dosjen gjyqësore, atëherë është në funksionin e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore.

23. Megjithatë, Gjykata ka theksuar se kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, atëherë vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) për mospranimin e rekursit, vë në dyshim të drejtën për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 3, datë 23.1.2014; nr. 19, datë 19.7.2005; nr. 22, datë 6.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Sa më sipër, Gjykata vlerëson se nisur nga natyra e pretendimeve të paraqitura në rekurs nga kërkueset, mungesa e arsyetimit të argumenteve në vendimin nr. 00-2012-2416, datë 16.11.2012, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, përbën një mangësi në përmbajtjen dhe në arsyetimin e vendimit të asaj gjykate.

25. Si rrjedhim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkueseve, për cenimin e parimit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, është i bazuar.

B . Lidhur me pretendimet e tjera

26. Kërkueset pretendojnë se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, me vendimet e tyre, kanë cenuar disa parime kushtetuese, si parimi i gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, parimi i disponibilitetit. Gjithashtu kërkueset pretendojnë se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) me vendimin nr. 00-2012-2416, datë 16.11.2012, duhet të merrte në konsideratë vendimin e tij të mëparshëm nr. 00-2011-1338 (348), datë 30.6.2011 dhe vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë nr. 29947/1, të cilin vetë e kishte lënë në fuqi. Gjykata e Lartë, duke vendosur mospranimin e rekursit, ka lënë në fuqi vendime të cilat bien në kundërshtim me njëra-tjetrën, duke cenuar parimin e sigurisë juridike.

27. Në jurisprudencën e saj Gjykata është shprehur se, në harmoni me parimin e sigurisë juridike, ligji procedural civil ka sanksionuar edhe parimin e gjësë së gjykuar (*res judicata*), parim i cili pengon dhënien e çdo vendimi të ri mbi atë që është gjykuar. Cenimi i parimit të gjësë së gjykuar do të çonte në cenimin e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetuese e ligjore të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës, pra në cenim të vetë sigurisë juridike. Siguria juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit tek shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin. Ndërsa, në rastin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, siguria juridike nënkupton që, në rastet kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk duhet të vihet në dyshim. Kur vendimi ka marrë formë të prerë, ai është i detyrueshëm për palët, trashëgimtarët e tyre, për personat që tërheqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera. Asnjë gjykatë nuk mundet të gjykojë sërish të njëjtën padi kundrejt të njëjtave palë (*shih vendimin nr. 23, datë 8.6.2007, të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur dhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, e cila ka nënvizuar se parimi në bazë të të cilit një vendim përfundimtar i formës së prerë është gjë e gjykuar dhe zgjidh mosmarrëveshjen midis palëve me një efekt përfundimtar, është një element themelor i gjykimit të drejtë që garantohet nga neni 6 i Konventës në çështjet civile. Parimi i sigurisë juridike dikton që kur një mosmarrëveshje civile është shqyrtuar në

themel nga gjykata, vendimi i saj nuk vihet më në diskutim (*shih çështjen Kehaya dhe të tjerë kundër Bullgarisë, datë 12.1.2006*).

29. Duke iu referuar jurisprudencës kushtetuese, parimi i gjësë së gjykuar përfshin jo vetëm urdhërimet e dispozitivit të vendimit gjyqësor, por dhe vërtetimet e fakteve dhe zbatimin e së drejtës, të përcaktuara në pjesën përshkruese arsyetuese të vendimit, me kusht që të jenë kryer me qëllim dhënien e vendimit gjyqësor dhe t'i përkasin fakteve ose marrëdhënieve që kanë formuar objektin e gjykimit mbi të cilin gjykata ka dhënë vendimin e saj (*shih vendimet nr. 24, datë 12.11.2008, të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Gjykata, referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, thekson qëndrimin se kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Një linjë e tillë lidhur me raportin ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e kësaj Gjykate të kërkesave individuale, në bazë të nenit 131, shkronja "f", të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit). Një qëndrim i ndryshëm do ta kthente Gjykatën Kushtetuese në një instancë të zakonshme, gjë që nuk është funksioni i saj (*shih vendimet nr. 4, datë 28.2.2006; nr. 19 datë 2.4.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Për pasojë, Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë, në funksion të rolit të saj si gjykatë e ligjit, si dhe në kontrollin e respektimit të standardeve kushtetuese nga gjykatat më të ulëta, duhet të mbante një qëndrim të shprehur lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të sigurisë juridike, parimin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, dhe parimin e disponibilitetit, të parashtruara në rekurs nga kërkuueset.

32. Në përfundim, Gjykata Kushtetuese çmon se nisur nga natyra e pretendimeve, mungesa e arsytimit të argumenteve në vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, përbën cenim të procesit të rregullt ligjor.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja "f", dhe nenit 134, pika 1, shkronja "g", të Kushtetutës; neneve 72 dhe 77 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë" njëzëri²,

² Gjyqtari S. Berberi ka votuar për shfuqizimin e vendimit nr. 1607, datë 24.11.2009, të Gjykatës së Apelit Tiranë për mosrespektim të standardit të arsytimit të vendimit dhe i është bashkuar shumicës për shfuqizimin e vendimit nr. 00-2012-2416, datë 16.11.2012, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), por me argumentin se ky i fundit ka lejuar cenimin e

VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës.
 - Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2012-2416, datë 16.11.2012, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).
 - Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha

VENDIM

Nr. 13, datë 17.3.2014

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

| | | | |
|-----------------|--------------------------------|---|---|
| Bashkim Dedja | kryetar i Gjykatës Kushtetuese | | |
| Sokol Berberi | anëtar i | " | " |
| Vitore Tusha | anëtar e | " | " |
| Altina Xhoxhaj | anëtar e | " | " |
| Fatmir Hoxha | anëtar i | " | " |
| Besnik Imeraj | anëtar i | " | " |
| Fatos Lulo | anëtar i | " | " |
| Vladimir Kristo | anëtar i | " | " |

me sekretare Blerina Basha, në datën 19.2.2014 mori në shqyrtim, në seancë plenare mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 2 Akti, që i përket:

KËRKUES: Dritan Fani

SUBJEKTI INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme, e përfaqësuar nga prokurori Bujar Sheshi.

OBJEKTI: Shfuqizimi, si i papajtuashëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, i vendimit nr. 00-2013-5, datë 10.1.2013, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).

BAZA LIGJORE: Nenet 42/2, 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Vladimir Kristo; mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarit, i cili është shprehur për pranimin e kërkesës dhe prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, që kërkoi rrëzimin e kërkesës dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin, me vendimin nr. 110, datë 20.7.2004, ka vendosur, ndër të tjera, deklarimin fajtor të kërkuesit për veprën penale të “vjedhjes me armë” në bashkëpunim, parashikuar nga neni 140 dhe 25 i Kodit Penal (KP) dhe dënimin e tij me 13 vjet burgim. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 156, datë 11.3.2005, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

2. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 85, datë 17.2.2006, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi me arsyetimin se ai nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

3. Ndërkohë që vuante dënimin, kërkuesi me vendimin nr. 59, datë 3.5.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, është deklaruar përsëri fajtor, për një ngjarje tjetër të kryer para dhënies së vendimit të parë, për veprën penale të “vjedhjes me armë” në bashkëpunim, parashikuar nga neni 140 dhe 25 i KP-së dhe është dënuar me 12 vjet burgim. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. 45, datë 25.1.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

4. Në këto kushte, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kurbin, bazuar në nenet 55/2 dhe 56 të KP-së, ka kërkuar bashkimin e dënimeve penale të dhëna ndaj kërkuesit me vendime të formës së prerë, si dhe caktimin e një dënimi përfundimtar.

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin, me vendimin nr. 482/64, datë 13.5.2009, ka vendosur pranimin e kërkesës, bashkimin e dënimit të ri prej 12 vjetësh të dhënë me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin nr. 59, datë 3.5.2007, me pjesën e mbetur të dënimit të mëparshëm. Dënimin përfundimisht të kërkuesit me një dënim të vetëm prej 13 vjetësh. Gjykata ka caktuar gjithashtu se vuajtja e dënimit fillon në datën e arrestimit (fillestar) të kërkuesit, pra më 28.11.2002. Vendimi në fjalë ka marrë formë të prerë, pa u ankimuar nga asnjë prej palëve ndërgjyqëse.

6. Në vitin 2012, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kurbin, bazuar në nenet 114 dhe 385 të KPP-së, i është drejtuar përsëri Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin për ndreqjen e gabimit material të vendimit nr. 482/64, datë 13.5.2009. Kjo e fundit, me vendim nr. 44, datë 26.3.2012, ka vendosur pranimin e kërkesës; ndreqjen e pjesës urdhëruese të vendimit penal nr. 482/64, datë 13.5.2009, duke caktuar si datë të fillimit të vuajtjes së dënimit, atë të kërkesës për bashkimin e dënimeve, pra më 24.3.2009.

7. Kundër vendimit të ndreqjes së gabimit material ka paraqitur ankim kërkuesi dhe Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 713, datë 4.7.2012, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 44, datë 26.3.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

8. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2013-5, datë 10.1.2013, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi, me arsyetimin se ai nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 432 të KPP-së.

II

9. **Kërkuesi** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) duke pretenduar shfuqizimin e vendimit nr. 00-2013-5, datë 10.1.2013, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Ai parashtron se ky vendim i ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor në drejtimet e mëposhtme:

9.1 Vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë ka cenuar parimin e arsytimit të vendimit gjyqësor, pasi ky vendim nuk arsyeton shkaqet e mospranimit të tij, edhe pse nga kërkuesi janë pretenduar shkelje të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor nga gjykatat më të ulëta, si dhe shkaqe të parashikuara nga neni 432 i KPP-së, të tilla si:

9.1.1 Vendimi i gjykatës së shkallës së parë dhe ai i apelit (të vitit 2012), duke korrigjuar datën e fillimit të vuajtjes së dënimit të ri, kanë cenuar një vendim të formës së prerë.

9.1.2 Gjykata e shkallës së parë dhe ajo e apelit kanë vepruar në kundërshtim me nenin 56/1 të KP-së, sepse në përcaktimin e datës së vuajtjes së dënimit nuk kanë respektuar rregullimin që pjesa e vuajtur e dënimit llogaritet në dënimin e ri.

9.1.3 Gjykata e shkallës së parë dhe ajo e apelit nuk kanë respektuar nenin 55/2 të KP-së, sepse duke korrigjuar datën e fillimit të vuajtjes së dënimit të ri, kanë kapërcyer kufirin më të lartë të parashikuar për llojin e dënimit të dhënë.

9.1.4 Në rastin konkret nuk mund të zbatohen nenet 114 dhe 385 të KPP-së, në të cilët gjykata e shkallës së parë dhe ajo e apelit kanë mbështetur vendimet e tyre (të vitit 2012) dhe prekja e masës së dënimit të caktuar në dispozitivin e vendimit konsiston në ndryshim vendimi dhe jo ndreqje të tij.

9.1.5 Edhe gjykata e apelit ka pranuar paligjshmërinë e vendimit të shkallës së parë, por ka gabuar duke lejuar mjetin e ndreqjes së gabimit material për korrigjimin e tij.

10. **Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme**, ka paraqitur me shkrim, në mënyrë të përmbledhur, këto prapësime:

10.1 Pretendimi i kërkuesit për cenimin e vendimit të formës së prerë nuk është i bazuar, pasi vendimet objekt shqyrtimi nuk janë shprehur për të njëjtin objekt gjykimi të vendimit të mëparshëm (nr. 482/64, datë 13.5.2009), pra nuk kanë të bëjnë me bashkimin e dënimeve, por thjesht me ndreqjen e gabimit material që është verifikuar në të.

10.2 Vendimet e gjykatave të faktit kanë respektuar nenin 56/1 të KP-së, sepse në llogaritjen e dënimit të ri nga gjykatat është mbajtur parasysh pjesa e vuajtur e dënimit të parë. Nëse gjykatat do të përcaktonin si datë të fillimit të vuajtjes së dënimit të ri atë të arrestimit fillestar të kërkuesit, ky i fundit për veprën penale të dytë nuk do të kryente asnjë lloj dënimi, pasi masa e dënimit të parë dhe ajo e caktuar pas bashkimit të dënimeve është po 13 vjet burgim.

10.3 Është respektuar neni 55/2 i KP-së pasi lloji i dënimit, ai me burgim, sipas sanksionimit të nenit 32 të KP-së, në kohën e dhënies së vendimit, parashikonte si kufi më të lartë të burgimit 25 vjet. Pikërisht ky kufi nuk duhet të kalohet në rast të bashkimit të dënimeve.

10.4 Gjykatat nuk kanë ndërhyrë në masën e dënimit të caktuar, por thjesht kanë korrigjuar datën nga e cila duhej bërë llogaritja e dënimit të caktuar pas bashkimit të dënimeve. Sipas përcaktimeve të neneve 114 dhe 385 të KPP-së, gjykatës që ka dhënë vendimin i lejohet çdo lloj korrigjimi i gabimit material.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

Për pretendimin e cenimit të parimit të arsytimit të vendimit

11. Kërkuesi pretendon se vendimet e gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit që kanë pranuar kërkesën e prokurorit për ndreqje të gabimit material të një vendimi të formës së prerë, janë në kundërshtim me ligjin material dhe procedural penal, pasi në përcaktimin e datës së re të fillimit të vuajtjes së dënimit, pas bashkimit të dënimeve, janë shkelur nenet 55 dhe 56 të KP-së. Në këtë mënyrë, gjykatat jo vetëm kanë cenuar një vendim të formës së prerë, por duke korrigjuar datën e fillimit të vuajtjes së dënimit të ri nuk kanë llogaritur dënimin e vuajtur. Ato, gjithashtu, në dhënien e një dënimi të vetëm kanë kapërcyer kufirin më të lartë të parashikuar për llojin e dënimit të dhënë. Sipas kërkuesit, po në këtë drejtim, gjykatat kanë gabuar sepse prejka e masës së dënimit ka të bëjë me ndryshim vendimi dhe jo me ndreqje të tij.

12. Këto shkelje të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor nga gjykatat e faktit, kërkuesi parashtron se i ka ngritur në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë dhe se kjo e fundit duhet t'u jepte përgjigje vetëm në seancë gjyqësore. Vendimi i Gjykatës së Lartë, përderisa nuk paraqet shkaqet e mospranimit të rekursit të tij, cenon parimin e arsytimit të vendimit gjyqësor.

13. Gjykata ripohon se e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga neni 42, 142/1 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep

mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (*shih vendimet nr. 8, datë 28.2.2012; nr. 8, datë 16.3.2011; nr. 25, datë 10.6.2011 dhe nr. 38, datë 30.12.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në jurisprudencën e saj, Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsytimit të vendimeve gjyqësore, penale apo civile, si një garanci për procesin ligjor. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Arsytimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Vendimi mund të kontrollohet nga një gjykatë më e lartë sipas procedurave përkatëse dhe, që kjo të jetë e mundur, duhet bërë arsyetimi i vendimit, në të cilin gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm, të cilat e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive. Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit, përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Ato përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim (*shih vendimet nr. 8, datë 16.3.2011; nr. 23, datë 4.11.2008; nr. 11, datë 2.4.2008 dhe nr. 7, datë 9.3.2009, të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë gjithashtu të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik (*shih vendimet nr. 20, datë 13.4.2012 dhe nr. 38, datë 30.12.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Gjithsesi, Gjykata e ka vlerësuar zbatimin e këtij parimi rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsytimin e vendimeve të tyre. Ajo ka verifikuar nëse vendimi i kundërshtuar është logjik, ka kundërthënie, përmban referencat në ligjin e zbatueshëm dhe nëse respekton të gjithë elementet e sipërpërmendura. Detyrimi i gjykatave për

të respektuar këtë standard ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete dhe natyrës së vendimit dhe masa e arsytimit varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimin nr. 25, datë 10.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në këtë kontekst, Gjykata ka theksuar se ajo e vlerëson arsytimin e një vendimi gjyqësor vetëm në kuadrin e përbushjes ose jo të standardeve të mësipërme pasi nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit. Kjo mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe, në aspektin e kontrollit kushtetues, Gjykata verifikon nëse arsytimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara më sipër, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Në vlerësimin e Gjykatës nuk mjafton që arsytimi të jetë formalisht i pranishëm në kuptimin grafik dhe strukturor, pasi kjo do ta bënte atë thjesht fiktiv. Arsytimi duhet domosdoshmërisht të plotësojë kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimin nr. 55, datë 18.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Gjykata është shprehur edhe lidhur me zbatimin e këtij detyrimi nga Gjykata e Lartë, për vendimet e dhëna prej saj në dhomë këshillimi dhe, referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, ka theksuar se vetëm kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, atëherë vendimi i Kolegjit, për mospranimin e rekursit, vë në dyshim të drejtën për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet n. 19, datë 19.7.2005; nr. 22, datë 6.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në rastin objekt shqyrtimi, Gjykata vëren se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kurbin, bazuar në nenet 55 dhe 56 të KP-së, pasi ka konstatuar ekzistencën e dy vendimeve të formës së prerë ndaj kërkuesit, njëri prej të cilëve në ekzekutim, ka kërkuar bashkimin e dënimit të ri prej 12 vjetësh me pjesën e mbetur të dënimit të mëparshëm (prej 5 vjet, 4 muaj dhe 3 ditë) duke përcaktuar për efekte përlogaritjeje dënimi datën e arrestimit të tij, më 28.11.2002. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin, me vendimin nr. 482/64, datë 13.5.2009, ka pranuar kërkesën e prokurorit duke dënuar përfundimisht kërkuesin me një dënim të vetëm prej 13 vjet burgim. Ajo ka përcaktuar si datë të fillimit të vuajtjes së dënimit datën 28.11.2002.

20. Pas pothuajse 3 vjetësh nga momenti kur vendimi për bashkimin e vendimeve kishte marrë formë të prerë, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kurbin ka kërkuar ndreqjen e gabimit material të vendimit të lartpërmendur

në lidhje me korrigjimin e datës së fillimit të vuajtjes së dënimit të ri, pra ndryshimin nga data e arrestimit fillestar të kërkuesit, në datën e kërkesës për bashkimin e dënimeve, më 24.3.2009. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin, me vendimin nr. 44, datë 26.3.2012, ka pranuar kërkesën e prokurorit, vendim i cili është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë.

21. Në këto kushte, Gjykata konstaton se për efekt të bashkimit të dënimeve në ngarkim të kërkuesit dhe të pjesës të dënimit të vuajtur prej tij (7 vjet, 7 muaj dhe 27 ditë), gjykatat, duke vendosur që masa e dënimit përfundimtar prej 13 vjet burgim të fillojë nga data 24.3.2009, i kanë caktuar atij të vuajë një dënim të vetëm prej 20 vjet, 7 muaj dhe 27 ditë.

22. Nga sa më lart, Gjykata vëren se të dyja gjykatat e faktit, në vendimet përkatëse për ndreqjen e gabimit material, lidhur me bashkimin e dënimeve, bazuar në rrethanat e çështjes, u referohen kriterëve të sanksionuara në nenin 56/1 të KP-së, sipas të cilit pjesa e vuajtur e dënimit llogaritet në dënimin e ri. Pavarësisht kësaj rrethane, gjykatat në arsytimin e tyre, në llogaritjen e dënimit përfundimtar, kanë mbajtur parasysh vetëm pjesën e pavuajtur të dënimit të parë dhe për këtë shkak kanë caktuar si datë të fillimit të vuajtjes së dënimit datën e kërkesës së prokurorit për bashkimin e dënimeve.

23. Gjykata çmon se ligjvënësi, për t'i dhënë vlerë parimit kushtetues të funksionit riedukativ të dënimit, institutin e bashkimit të dënimeve e rregullon në dy aspekte, të cilat janë të sanksionuara në nenin 56 të KP-së. Në paragrafin e parë të këtij neni parashikohet rasti kur i dënuari, para vuajtjes së plotë të dënimit, dënohet për një veprë të kryer para dhënies së dënimit që është duke vuajtur. Në këtë rast pjesa e vuajtur e dënimit llogaritet në dënimin e ri. Në paragrafin e dytë të nenit 56 të KP-së parashikohet rasti kur i dënuari, pas dhënies së vendimit, por para vuajtjes së plotë të tij, kryen një veprë penale të re. Në këtë rast gjykata bën bashkimin e dënimit të ri me pjesën e mbetur të dënimit të mëparshëm. Pra pjesa e vuajtur e dënimit nuk mbahet parasysh për efekt të bashkimit të dënimeve. Ky moment përcakton edhe dallimin kryesor midis dy paragrafëve të nenit 56 të KP-së. Ai ka rëndësi për të përcaktuar shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të personit, pasi si rregull, personi që kryen një veprë penale të re, pasi është dënuar më parë, paraqet rrezikshmëri më të madhe shoqërore se ai që nuk është dënuar më parë.

24. Në këtë këndvështrim, Gjykata vlerëson se vendimet e gjykatave të faktit nuk kanë arsyetuar me qartësi lidhur me këto dy aspekte të bashkimit të dënimeve, pra me momentin që kërkuesi ka kryer veprën e dytë penale, i cili përcakton dhe mënyrën e llogaritjes së vuajtjes së dënimit përfundimtar. Po në këtë aspekt, gjykatat nuk kanë arsyetuar edhe në lidhje

me kohën që të pandehurit i ngelet akoma për të vuajtur. Këto të meta nuk janë riparuar as nga Gjykata e Lartë, për më tepër kur kërkuesi ka pretenduar se në kundërshtim me nenin 55/2 të KP-së, është kapërcyer kufiri më i lartë i parashikuar për llojin e dënimit të dhënë kërkuesit (dënimi maksimal i parashikuar në nenin 140 të KP-së është 20 vjet burgim).

25. Gjykata çmon se kjo paqartësi në përmbajtjen e vendimeve, në rastin konkret, cenon parimet kushtetuese të shtetit të së drejtës, të barazisë përpara ligjit, të drejtësisë në caktimin e fajësisë dhe të dënimit, si dhe të humanizmit (shih nenin 1/c të KP-së) ku bazohet legjislacioni penal. Kjo e metë, gjithashtu, bie ndesh me thelbin e të drejtës për faktin se vendimet e gjykatave të faktit, të lartpërmendura, duke korrigjuar pas një harku kohor prej 3 vjetësh një vendim të formës së prerë, kanë rënduar pozitën e të pandehurit, i cili kishte krijuar pritshmëri të ligjshme në lidhje me kohëzgjatjen e dënimit përfundimtar.

26. Për pasojë, nga leximi në tërësi i vendimeve të gjykatave të faktit, Gjykata vlerëson se, për shkakun e lartpërmendur, rrjedha logjike e përdorur në këto vendime nuk rezulton e qartë dhe e kuptueshme dhe se argumentet e pjesës hyrëse nuk janë të lidhura logjikisht me pjesën arsyetuese dhe atë urdhëruese. Ato nuk formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, çka bën që përmbajtja dhe arsyetimi i tyre të mos kenë një harmoni të brendshme. Për këtë arsye, Gjykata çmon se mungesa e qartësisë së vendimeve të gjykatave të faktit përbën një të metë, të pakapërcyeshme, të përmbajtjes së secilit prej këtyre vendimeve dhe të arsyetimit të gjykatës.

27. Gjykata vëren se kjo e metë e vendimeve të gjykatave të faktit ka të bëjë me probleme të interpretimit dhe të zbatimit të ligjit që lidhen me zgjidhjen e çështjes konkrete, e cila nuk është korrigjuar nga Gjykata e Lartë pasi ajo nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuesit edhe pse shkaqet e ngritura në rekurs nga kërkuesi janë shoqëruar me cenimin e të drejtave kushtetuese të kërkuesit që duhen respektuar në procesin e shqyrtimit të çështjes.

28. Për pasojë, Gjykata çmon se në kushtet kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e dispozitave procedurale që kanë ndikuar në dhënien e vendimit, si dhe të parimeve themelore të procesit të rregullt ligjor, Gjykata e Lartë duhet të mbante një qëndrim të shprehur lidhur me pretendimet e ngritura nga kërkuesi, si në funksion të rolit të saj si gjykatë e ligjit ashtu dhe në kontrollin e respektimit e standardeve kushtetuese nga gjykatat më të ulëta.

29. Si përfundim, nisur nga sa më sipër, Gjykata çmon se vendimi i mospranimit të rekursit, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, objekt shqyrtimi, nuk ka respektuar standardin kushtetues të arsyetimit të

vendimeve gjyqësore. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesit në këtë aspekt është i bazuar dhe duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “f”, dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g”, të Kushtetutës; neneve 72 dhe 77 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Shfuqizimin e vendimit nr.00-2013-5, datë 10.1.2013 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Besnik Imeraj, Fatmir Hoxha, Vladimir Kristo

Anëtarë kundër: Sokol Berberi, Altina Xhoxhaj, Fatos Lulo

MENDIM PAKICE

Për arsye se nuk ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën, lidhur me përfundimin e arritur në këtë çështje dhe argumentet mbi të cilat mbështetet ky qëndrim, e çmoj të rëndësishëm të shprehem me mendim pakice.

Nëpërmjet arsyetimit të saj, shumica ka theksuar se vetëm kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, atëherë vendimi i Kolegjit, për mospranimin e rekursit, vë në dyshim të drejtën për një proces të rregullt ligjor (*prg. 18 i vendimit*). Duke arsyetuar më tej, ajo ka çmuar se e meta e vendimeve të gjykatave të faktit ka të bëjë me probleme të interpretimit dhe të zbatimit të ligjit që lidhen me zgjidhjen e çështjes konkrete, e cila nuk është korrigjuar nga Gjykata e Lartë, pasi ajo nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuesit, edhe pse shkaqet e ngritura në rekurs nga kërkuesi janë shoqëruar me cenimin e të drejtave kushtetuese të kërkuesit, që duhen respektuar në procesin e shqyrtimit të çështjes (*prg. 27 i vendimit*). Bazuar në këtë qëndrim, shumica ka konkluduar se në rastin konkret është cenuar standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor, pasi në kushtet kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e dispozitave procedurale që kanë ndikuar në dhënien e vendimit, si dhe të parimeve themelore të procesit të rregullt ligjor, Gjykata e Lartë duhet të mbante një qëndrim të shprehur lidhur me pretendimet e ngritura nga kërkuesi (*prg. 28 i vendimit*).

Nuk pajtohem me këtë përfundim të shumicës, pasi, në vlerësimin tim, Gjykata e Lartë i ka dhënë përgjigje kërkuesit në vendimin e saj, të marrë në dhomë këshillimi. Ky qëndrim mbështetet në jurisprudencën e Gjykatës, sipas të cilës arsyetimi i kufizuar i vendimit të marrë në dhomën e këshillimit nuk e cenon procesin e rregullt ligjor. Kjo formë arsyetimi është tashmë e konsoliduar në praktikën e Gjykatës së Lartë, përderisa shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit, nga ana e kolegeve të saj, gjatë shqyrtimit të tij paraprak në dhomën e këshillimit. Siç ka evidentuar edhe shumica në paragrafin 7 të vendimit, sikundër për pranimin, ashtu edhe për mospranimin e rekursit, dhoma e këshillimit luan rolin e një filtri të kërkesave që i drejtohen Gjykatës së Lartë. Veprimtaria seleksionuese e dhomës së këshillimit është një veprimtari e domosdoshme në funksion të aksesit në gjykatë vetëm të atyre çështjeve që i parashikon ligji, duke lënë jashtë përzgjedhjes kërkesat e paarsyeshme dhe haptazi të pambështetura në ligj. Sipas këtyre standardeve, kur kërkesat e ligjit për kalimin në seancë nuk janë plotësuar, vendoset për mospranimin e kërkesës dhe ky lloj shqyrtimi paraprak vlerësues është kompetencë vetëm e trupës së gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, dhe nuk mund të bëhet pjesë e kontrollit kushtetues që zhvillon Gjykata (*shih vendimet nr. 34, datë 12.7.2013; nr. 108, datë 3.10.2012, dhe nr. 17, datë 17.5.2011, të Gjykatës Kushtetuese; vendimin nr. 143, datë 7.12.2011 të Mbledhjes së Gjyqtarëve*).

Edhe GJEDNJ-ja ka theksuar se: “detyrimi që ka gjykata vendase për të arsyetuar vendimet e saj, nuk mund të interpretohet sikur kërkohet arsyetim i detajuar për çdo pretendim të palës ndërgjyqëse. Masa e arsyetimit të vendimit varet nga natyra e vendimit në fjalë” (...) “arsyetimi i kufizuar i dhënë nga Gjykata e Lartë në formulimin e vendimit në dhomë këshillimi, në mënyrë të nënkuptuar evidenton se aplikanti nuk ka ngritur një nga argumentet ligjore të përcaktuara në dispozitën përkatëse të legjislacionit të brendshëm, që është kusht për pranimin e kërkesës. Gjykata vëren se, kur një gjykatë e lartë refuzon të pranojë një çështje, për arsye se mungojnë shkaqet ligjore për ngritjen e çështjes, një arsyetim shumë i kufizuar mund të përmbushë kriterin e nenit 6 të Konventës” (*Marini kundër Shqipërisë, datë 18.12.2007, §105-106; Mishgjoni kundër Shqipërisë, datë 7.12.2010, § 51*).

Për më tepër, siç jam shprehur me mendim pakice në vendimet nr. 3, datë 23.1.2014 dhe nr. 4, datë 5.2.2014, vlerësoj se standardi mbi të cilin mbështetet shumica nuk krijon garanci për ruajtjen e vlerave të uniformitetit, qëndrueshmërisë dhe parashikueshmërisë në zbatimin e të drejtës dhe, për pasojë, lë hapësirë për cenimin e sigurisë juridike dhe të barazisë përpara ligjit. Këtë vlerësim e mbështes në arsyet që vijojnë.

Shumica ka vlerësuar se në kushtet kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e dispozitave procedurale, që kanë ndikuar në dhënien e vendimit, si dhe të parimeve themelore të procesit të rregullt ligjor, Gjykata e Lartë duhet të mbajë një qëndrim të shprehur, lidhur me pretendimet e ngritura nga kërkuesi. Në një arsyetim *a contrario*, bazuar në qëndrimin e mësipërm, nëse në rekurs nuk ngrihen pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, Gjykata e Lartë nuk është e detyruar t’u japë përgjigje pasi në këto raste është i mjaftueshëm një arsyetim i kufizuar, që e përmbush standardin kushtetues të arsyetimit. Ky lloj diferencimi në arsyetim, i lidhur me natyrën e pretendimeve të ngritura në rekurs, është bërë nga shumica pa parashtruar motivet se përse arsyetimi i kufizuar konsiderohet i rregullt, në aspektin kushtetues, në disa raste, dhe i parregullt në raste të tjera.

Nisur nga ky arsyetim i shumicës lind pyetja: nëse pretendimet e ngritura në rekurs kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, a duhet t’u japë përgjigje atyre edhe Gjykata e Kushtetuese? Me qëndrimin e saj shumica ka lënë shteg për një lloj ndërhyrjeje të Gjykatës Kushtetuese në rolin vlerësues të Gjykatës së Lartë. Kështu shumica, në rastin konkret, ka vlerësuar përmbajtjen e rekursit, konkretisht duke identifikuar se shkaqet e ngritura në rekurs janë shoqëruar me cenimin e të drejtave kushtetuese të kërkuesit dhe i ka imponuar Gjykatës së Lartë mënyrën e arsyetimit në lidhje me këto pretendime. Vlerësimi i rekursit është atribut i Gjykatës së Lartë, e cila vlerëson pretendimet e ngritura në rekurs në dhomë këshillimi. Ajo verifikon nëse rekursi i plotëson ose jo kushtet për shqyrtim dhe, sipas rastit, vendos pranimin ose mospranimin e rekursit. Gjithashtu, duke vlerësuar se Gjykata e Lartë duhet të mbante qëndrim, në rastin konkret, në lidhje me problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit, shumica ka ndërhyrë në funksionin vlerësues të Gjykatës së Lartë, si gjykatë ligji (*shih prg. 22 dhe 24 të vendimit*). Vlerësimi i aspekteve të interpretimit të ligjit dhe zbatimit të tij në çështje konkrete nuk mund t’i imponohet Gjykatës së Lartë nga Gjykata. Në vijim të këtij arsyetimi, çmoj se vlerësimi i procesit të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, në këndvështrim të respektimit të nenit 42 të Kushtetutës, duhet të bëhet nga Gjykata gjithnjë brenda kuadrit të kompetencave të saj, çka përjashton vlerësimin e përmbajtjes së rekursit dhe detyrimin e Gjykatës së Lartë për të ndjekur mënyra të ndryshme për vlerësimin e pretendimeve.

Gjithashtu, me qëndrimin e saj shumica krijon paqartësi për sa i përket mundësisë që ka kërkuesi për ta goditur për antikushtetutshmëri të njëjtin vendim, pas rigjykimit në Gjykatën e Lartë. A mundet Gjykata ta

kontrollojë përsëri nga pikëpamja kushtetuese të njëjtin vendim pasi çështja të jetë rigjykuar në Gjykatën e Lartë? Në rastin konkret shumica, edhe pse e ka kthyer çështjen në Gjykatën e Lartë, ka bërë një vlerësim të pretendimeve, që në çmuarjen e saj kanë natyrë kushtetuese. Rrjedhimisht, qëndrimi i shumicës në këtë rast nuk i shërben efektivitetit të shqyrtimit kushtetues dhe respektimit të së drejtës për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm.

Si përfundim, për sa më lart, çmoj se në rastin konkret pretendimi i kërkuesit në drejtim të cenimit të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, është i pabazuar, ndaj kërkesa e paraqitur duhej të ishte rrëzuar.

Anëtar: Sokol Berberi

MENDIM PAKICE

Në çështjen me kërkues Dritan Fani jemi kundër qëndrimit të shumicës për shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën, të vendimit nr. 5, datë 10.1.2013, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Në jurisprudencë konstante Gjykata ka theksuar se, bazuar në nenin 433 të KPP-së, është në kompetencë të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) të analizojë dhe të vlerësojë nëse shkaqet e ngritura në rekurs janë në përputhje me kërkesat e ligjit. Në rast se Kolegji, në dhomën e këshillimit, krijon bindjen se ato janë haptazi të pabazuara, pasi nuk bëjnë pjesë në shkaqet që parashikon dispozita ligjore ose nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore, atëherë është në funksionin e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore.

Megjithatë, Gjykata ka theksuar se kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, atëherë vendimi i Kolegjit, për mospranimin e rekursit, vë në dyshim të drejtën për një proces të rregullt ligjor (shih vendimet nr. 19, datë 19.7.2005; nr. 22, datë 6.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese). Kjo sepse, referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Ky raport midis juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese të kërkesave individuale, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit) (*shih vendimet nr. 4, datë 28.2.2006; nr. 19 datë 2.4.2012; nr. 58, datë 24.12.2012; nr. 36, datë 25.7.2013; nr. 52, datë 2.12.2013, të Gjykatës Kushtetuese*).

Në kuptim të sa më sipër, jurisprudenca e Gjykatës ka ecur në linjën që, një vendim gjyqësor i dhomës së këshillimit cenon të drejtën për një proces të rregullt në ato raste kur në procesin e zhvilluar në shkallët më të ulëta të gjykimit është konstatuar cenimi i kësaj të drejte kushtetuese të individit, në një nga elementet përbërëse të saj, e cila është e vetmja e drejtë kushtetuese procedurale që i lejon individit të mbrojë të drejtat e tjera të tij substanciale. Në rast të evidentimit të një cenimi të tillë, gjatë gjykimit në shkallët e tjera, Gjykata, në zbatim të parimit të subsidiaritetit, e ka kthyer çështjen në Gjykatën e Lartë, në mënyrë që vetë ajo gjykatë, në funksion të pozicionit të saj në piramidën gjyqësore, të mund të riparojë shkeljet e kryera brenda sistemit gjyqësor. Kjo sepse Gjykata e Lartë, në funksion të rolit të saj si gjykatë e ligjit, si dhe në atë të kontrollit të respektimit të standardeve kushtetuese nga gjykatat më të ulëta, duhet të mbajë qëndrim të shprehur lidhur me pretendimet e ngritura nga individët për cenimin e një prej standardeve të procesit të rregullt, të evidentuara në gjykimin e faktit.

Por, në rastet kur Gjykata nuk konstaton cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor në procesin gjyqësor të zhvilluar në të tri shkallët e gjykimit, ajo nuk vë në dyshim procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë, duke u mbështetur thjesht në faktin se ai ka vendosur mospranimin e rekursit në dhomë këshillimi. Ky proces është vënë në dyshim nga Gjykata vetëm në rastin kur këto vendime nuk përmbajnë shkaqet e ngritura në rekurs, çka, sipas saj, përbën cenim të parimit të arsytimit të vendimit gjyqësor. Megjithatë, edhe në lidhje me këtë parim Gjykata ka theksuar se ajo e vlerëson zbatimin e tij rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme këtë detyrim (shih vendimin nr. 25, datë 10.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese).

Në rastin konkret në shqyrtim, kërkuesi pretendon se vendimet e gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit, që kanë pranuar kërkesën e prokurorit për ndreqje të gabimit material të një vendimi të formës së prerë, janë në kundërshtim me ligjin material dhe procedural penal, pasi në përcaktimin e datës së re të fillimit të vuajtjes së dënimit, pas bashkimit të dënimeve, janë shkelur nenet 55 dhe 56 të KP-së. Në këtë mënyrë, sipas kërkuesit, gjykatat jo vetëm kanë cenuar një vendim të formës së prerë, por duke korrigjuar datën e fillimit të vuajtjes së dënimit të ri nuk kanë llogaritur dënimin e vuajtur.

Shumica, duke interpretuar nenin 56 të KP-së ka argumentuar se vendimet e gjykatave të faktit nuk kanë arsytuar me qartësi lidhur me dy aspekte të bashkimit të dënimeve. Gjithashtu, shumica argumenton se gjykatat nuk kanë arsytuar edhe në lidhje me kohën që të pandehurit i ngelet akoma për të vuajtur nga dënimi i

dhënë. Këto të meta, sipas shumicës, nuk janë riparuar as nga Gjykata e Lartë dhe, përfundimisht, ajo ka pranuar kërkesën duke shfuqizuar vendimin e Gjykatës së Lartë, me arsyetimin se ajo nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuarit edhe pse shkaqet e ngritura në rekurs nga kërkuari janë shoqëruar me cenimin e të drejtave kushtetuese që duhen respektuar në procesin e shqyrtimit të çështjes.

Nuk bashkohemi me qëndrimin e shumicës pasi në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me institutin e bashkimit të dënimeve. Në vendimin e gjykatës së shkallës së parë, lënë në fuqi me vendimin e gjykatës së apelit, është bërë ndreqja e një gabimi material që është verifikuar në vendimin përfundimtar të gjykatës për bashkimin e dënimeve të dhëna kërkuarit dhe, konkretisht, vendimit nr. 482/64, datë 13.5.2009. Sipas përcaktimeve të nenit 114 të KPP-së, ndreqja e vendimeve me gabime materiale bëhet dhe kryesisht nga gjykata që ka nxjerrë aktin, ndërsa sipas nenit 385 të KPP-së, gjykata dhe kryesisht procedon për ndreqjen e vendimit kur duhet korrigjuar ndonjë gabim material. Në rastin konkret, gjykata me kërkesë të prokurorit ka korrigjuar datën nga e cila duhej bërë llogaritja e dënimit të caktuar pas bashkimit të dënimeve dhe nuk ka ndërhyrë në masën e dënimit të caktuar për kërkuarin.

Në këto kushte, edhe Kolegji Penal në dhomën e këshillimit, bazuar në nenin 433 të KPP-së, ka vlerësuar se shkaqet e ngritura në rekurs janë të ndryshme nga ato që parashikon ligji për paraqitjen e rekursit ndaj ka vendosur mospranimin e tij.

Për sa më sipër, vlerësojmë se kërkesa e kërkuarit për shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si pasojë e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, duhej rrëzuar si e pabazuar.

Anëtarë: Fatos Lulo, Altina Xhoxhaj

VENDIM Nr. 15, datë 21.3.2014

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

| | |
|-----------------|--------------------------------|
| Bashkim Dedja | kryetar i Gjykatës Kushtetuese |
| Vladimir Kristo | anëtar i “ “ |
| Sokol Berberi | anëtar i “ “ |
| Vitore Tusha | anëtar e “ “ |
| Altina Xhoxhaj | anëtar e “ “ |
| Fatmir Hoxha | anëtar i “ “ |
| Besnik Imeraj | anëtar i “ “ |
| Gani Dizdari | anëtar i “ “ |

me sekretare Blerina Basha, në datën 29.10.2013, mori në shqyrtim mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 40/13 Akti, që i përket:

KËRKUESE: Fatbardha Vokopola.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Anesti Çausi, Marjeta Prifti, Eleni Karamitro (Çausi), Theodhori Çausi

Agjencia Kombëtare e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave

OBJEKTI: Shfuqizimi, si i papajtuashëm me Kushtetutën, i vendimit nr. 1403, datë 18.7.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; i vendimit nr. 41, datë 10.9.2008, të Gjykatës së Apelit Vlorë; i vendimit nr. 00-2012-31, datë 19.1.2012, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).

BAZA LIGJORE: Neni 134, pika 1, shkronja “g”, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 43, pika “ç”, i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Gani Dizdari, shqyrtoi parashtrimet e kërkuarës, që kërkoi pranimin e kërkesës; prapësimet e subjektit të interesuar, që kërkoi rrëzimin e kërkesës dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuarja është bashkëpronare e një pasurie të paluajtshme truall me sipërfaqe 100 vreten, të kthyer me vendimin nr. 81, datë 14.6.1995, nga ish-Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP) Vlorë, si trashëgimtare e ish-pronarit Ferit Vokopola. Kjo pronë është regjistruar dhe në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP) Vlorë.

2. Ky vendim është kundërshtuar gjyqësisht nga kërkuarja, me objekt përcaktimin dhe saktësimin e kufijve të sipërfaqes së njohur dhe kthimin e një sipërfaqeje tjetër prej 11.250 m². Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 1468, datë 29.10.2002, ka ndryshuar vendimin e KKKP Vlorë duke i kthyer kërkuarës dhe bashkëpronarëve të tjerë edhe 11.500 m² të tjerë. Kjo pasuri është regjistruar gjithashtu në ZVRPP Vlorë.

3. Komisioni i Ndarjes së Tokës, Bashkia Vlorë, i ka dhënë trashëgimtarëve të Marie Çausit, ku bën pjesë dhe subjekti i interesuar, 4750 m² truall në përdorim, pronë e cila mbivendoset me pronën e kthyer në favor të kërkuarës dhe bashkëpronarëve të tjerë. Më pas, trualli i dhënë në përdorim është kaluar në pronësi të trashëgimtarëve të Marie Çausit. Për këtë arsye, kërkuarja i është drejtuar gjykatës me padë për të kundërshtuar vendimin nr. 100, datë 19.4.1996 të KKKP-së Vlorë në favor të Mihal Çausit, njërit prej trashëgimtarëve të Marie Çausit.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 1403, datë 18.7.2006, ka vendosur “Rrëzimin e padisë.”

5. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 1, datë 9.1.2007, ka vendosur: *“Lënien në fuqi të vendimit nr. 1403, datë 18.7.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë”*.

6. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 219, datë 18.3.2008, ka vendosur: *“Lënien në fuqi të vendimit nr. 1, datë 19.1.2007 të Gjykatës së Apelit Vlorë për pjesën që rrëzon padinë e paditëses Fatbardha Vokopola për kundërshtimin e vendimit nr. 100, datë 19.4.1994 të KKKP Vlorë. Prishjen e vendimit në lidhje me shtesën e objektit të padisë dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në atë gjykatë me trup tjetër gjykues.”*

7. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 41, datë 10.9.2008, ka vendosur: *“Lënien në fuqi të vendimit nr. 1403, datë 18.7.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë për pjesën që rrëzon padinë e paditëses Fatbardha Vokopola dhe çregjistrimin nga regjistrat hipotekorë të ZRPP Vlorë të pasurisë nr. 2/42 në emër të trashëgimtarëve të Marie Çaushtit.”*

8. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 31, datë 19.1.2012, ka vendosur: *“Mospranimin e rekursit.”*

II

9. **Kërkuesja** pretendon se gjykimi i kësaj çështjeje në të tri shkallët e gjykimit është bërë në kundërshtim me parimin e procesit të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42, 131/f të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, për këto arsye:

9.1. *Është cenuar parimi i paanshmërisë në gjykim nga Gjykata e Apelit.* Kryesuesja e trupit gjykues, I.B., ka qenë anëtare e trupit gjykues në gjykimin e çështjes për herë të parë nga Gjykata e Apelit Vlorë. Meqenëse u kërkua përjashtimi i saj nga gjykimi, gjykata e pranoi kërkesën duke u zëvendësuar nga gjyqtarja A.L. Kur e njëjta çështje u kthye për rigjykim në Gjykatën e Apelit nga Gjykata e Lartë, gjyqtarja I.B. nuk dha dorëheqjen, megjithëse ekzistonin të njëjtat kushte për të cilat ishte dorëhequr herën e parë. E njëjta situatë ka ndodhur edhe me gjyqtaren M.R. Në rigjykimin e kësaj çështjeje në Gjykatën e Apelit, kërkuesja pretendon se nuk ka pasur mundësi të kërkojë përjashtimin e gjyqtareve, pasi gjykimi në atë shkallë është zhvilluar në mungesë të kërkueses.

9.2. *Gjykatat kanë interpretuar gabim rrethanat dhe faktet e çështjes* duke vlerësuar si të ligjshëm aktin e marrjes së tokës në pronësi nga familja Çaushti, subjekti i interesuar në këtë gjykim.

9.3. *Është cenuar parimi i sigurisë juridike.* E drejta e pronësisë së kërkueses për sipërfaqen prej 100 vreten është njohur me vendimin nr. 81, datë 14.6.1995, të KKKP-së Vlorë. Kjo e drejtë është konfirmuar dhe nga vendimi nr. 1468, datë 29.10.2002, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Ndërsa Komisioni i Ndarjes së Tokës, me aktin e marrjes së tokës në përdorim në vitin

1995 dhe në pronësi me AMPT nr. 20724, datë 15.10.1996, ka disponuar të njëjtën pasuri në favor të familjes Çaushti.

9.4. *Është cenuar e drejta për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur.* Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, duke vendosur moskalimin e çështjes në seancë, ka mohuar të drejtën për t'u mbrojtur dhe për t'u dëgjuar nga gjykata.

10. **Subjekti i interesuar** parashtron se:

10.1 Pretendimi për anshmëri të trupit gjykues në Gjykatën e Apelit Vlorë, si rrjedhojë e pranisë në gjykim të gjyqtarës I.B. nuk është i bazuar, pasi gjykimi të cilit i referohet kërkuesja është tërësisht i ndryshëm nga procesi të cilin ajo ankimon si të parregullt para kësaj Gjykate. Po ashtu, edhe pretendimi lidhur me paanshmërinë e gjyqtarës M.R., e cila në gjykimin e parë të nisur nga kërkuesja kishte dhënë dorëheqjen, ndërsa pas kthimit për rigjykim nga Gjykata e Lartë nuk veptoi në të njëjtën mënyrë, është i paargumentuar. Ajo gjyqtare nuk e dha dorëheqjen herën e dytë, sepse, siç rezultoi edhe nga dosja, gjatë gjykimit të parë u vërtetua se ai proces nuk kishte lidhje me gjykimin tjetër të iniciuar po nga kërkuesja.

10.2 Lidhur me pretendimin tjetër të kërkueses për mosrealizimin e të drejtës së mbrojtjes para dhomës së këshillimit në Gjykatën e Lartë, duke qenë se u vendos moskalimi i çështjes për gjykim, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk kishte arsye pse të dëgjonte palët kur kriteret formale për pranimin e rekursit nuk ishin plotësuar.

10.3 Pretendimet e kërkueses lidhur me mohimin e të drejtës së pronës nëpërmjet një procesi të parregullt i referohen vetëm çështjeve të interpretimit të ligjit dhe jo standardeve kushtetuese. Gjykata kushtetuese nuk merr në shqyrtim çështje të interpretimit të ligjit, ato janë në juridiksion të gjykatave të zakonshme.

10.4 Kërkuesja nuk i ka shteruar mjetet juridike në kuptimin që ajo nuk i ka ngritur pretendimet e saj në shkallët më të ulëta të gjykimit dhe, për këtë shkak, nuk duhet të legjitimohet në kërkimet e saj.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Mbi kërkimet paraprake

11. Gjykata, fillimisht, e sheh të nevojshme të shprehet mbi disa kërkime paraprake të kërkueses. Së pari, me anë të kërkesës paraprake të kërkueses, të paraqitur para kësaj Gjykate, me datë 7.10.2013, kërkuesja kërkoi kufizimin e objektit të kërkesës vetëm në shfuqizimin si të papajtuësme me Kushtetutën të vendimit nr. 00-2012-31, datë 19.1.2012, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe vendimit nr. 41, datë 10.9.2008, të Gjykatës së Apelit Vlorë.

B. *Mbi pretendimin për anshmëri të trupit gjykues në Gjykatën e Apelit Vlorë*

12. Gjykata, në jurisprudencë të vazhdueshme, ka theksuar rëndësinë e respektimit të parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme, me qëllim respektimin e të drejtave të palëve gjatë gjithë procesit. Kështu, ajo ka theksuar se në kuptim të nenit 42/2 të Kushtetutës, ekzistojnë dy teste për të vlerësuar nëse një gjykatë është e paanshme: i pari, konsiston në përcaktimin e bindjes personale të gjyqtarit në një çështje konkrete. Ndërsa testi i dytë lidhet me vlerësimin nëse gjyqtari ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të ligjshëm në këtë drejtim. Përjashtimi i këtyre dyshimeve është garanci për besimin që duhet të frymëzojnë gjykatat në një shoqëri demokratike për publikun dhe mbi të gjitha, për palët në procesin gjyqësor (*shih vendimin nr. 18/2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Parimi i paanshmërisë ka në vetvete elementin e vet subjektiv, i cili lidhet ngushtë me bindjen e brendshme që krijon gjyqtari për zgjidhjen e çështjes në gjykim, si dhe elementin objektiv me të cilin kuptohet dhënia e garancive të nevojshme për gjykim të paanshëm nga vetë gjykata, përmes mënjanimit prej saj të çdo dyshimi të përligjur në këtë drejtim. Ndër të tjera, gjykata duhet të jetë e kujdesshme dhe të marrë parasysh veçanërisht problemin e përbërjes së trupit gjykues, në mënyrë që të mënjanohen nga gjykimi i çështjes gjyqtarët që nuk kanë garancitë e kërkuara për paanshmëri në kuptimin objektiv. Në shtetin e së drejtës, kjo kërkesë merr rëndësi të veçantë në funksion të besimit në dhënien e drejtësisë që duhet të krijojnë në çdo rast në shoqërinë demokratike jo vetëm palët në gjykim, por çdo qytetar i thjeshtë (*shih vendimet nr. 16/2003; nr. 7/2008; nr. 11/2008; nr. 23/2008; nr. 10/2009, të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në kuadrin e parimeve kushtetuese që qëndrojnë në themel të një procesi të rregullt gjyqësor, respektimi i parimit të paanshmërisë mundëson krijimin e besimit tek gjyqësori me qëllim që drejtësia jo vetëm të bëhet, por dhe të shihet që po bëhet. Në demokraci, ligjshmëria e rolit të gjyqtarit varet jo vetëm nga qenia e tij, por dhe nga shfaqja e tij i paanshëm dhe i pavarur, duke qenë se roli i tij gjatë gjykimit duhet të jetë pasiv dhe *super partes*. Kur shqyrtohet një çështje e caktuar ekziston një arsye legjitime për të dyshuar se një gjyqtar nuk është i paanshëm, këndvështrimi i atyre që paraqesin këtë pretendim ka rëndësi, por vendimtar mbetet përcaktimi nëse ky dyshim është objektivisht i justifikueshëm (*shih vendimet nr. 23/2008 dhe nr. 11/2013, të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Nisur nga këto standarde të përcaktuara në jurisprudencë të vazhdueshme nga kjo Gjykatë, duhen parë faktet dhe rrethanat e çështjes konkrete. Kështu, kërkesja pretendon se ka kërkuar përjashtimin e gjyqtarës I.B., duke iu referuar procesverbaleve të

seancës gjyqësore të datave 1.12.2006 dhe 26.12.2006, kërkesë e cila, sipas saj, nuk është marrë parasysh.

16. Gjykata, duke iu referuar dosjes gjyqësore, konkretisht, procesverbaleve përkatëse të gjykimit në Gjykatën e Apelit Vlorë, nuk evidenton ndonjë kërkesë për përjashtim. Kështu, në procesverbalin e datës 1.12.2006 është pasqyruar kërkesa e bërë nga kërkuësja për shtyrje të gjykimit, i cili u shty për në datën 26.12.2006. Nga procesverbali i kësaj seance nuk rezulton që gjyqtarja I.B. të jetë anëtare e trupit gjykues. Gjithashtu, në procesverbal nuk është pasqyruar ndonjë veprim tjetër që lidhet me këtë fakt si p.sh. heqje dorë nga vetë gjyqtari apo kërkesë. Gjykata vlerëson se për procesin gjyqësor në tërësi është i rëndësishëm fakti nëse gjyqtari që kundërshtohet nga kërkuësja ka qenë apo jo pjesë e trupit gjykues gjatë rigjykimit. Ky fakt nuk vërtetohet nga dosja gjyqësore, prandaj pretendimi për anshmëri të trupit gjykues nuk arriti të provohej para kësaj Gjykate.

17. I njëjti pretendim ngrihet edhe për gjyqtaren M.R., e cila në gjykimin e parë, me të njëjtat palë por me objekt të ndryshëm, ka kërkuar dorëheqjen nga gjykimi i çështjes, pasi ishte caktuar për të gjykuar një çështje tjetër me të njëjtat palë. Dorëheqja është pranuar nga kryetari i Gjykatës së Apelit Vlorë, gjë që është evidentuar në dosjen gjyqësore. Në gjykimin e dytë, pas kthimit për rigjykim nga Gjykata e Lartë, gjyqtarja M.R. ka qenë sërish në trup gjykues. Kësaj radhe gjyqtarja nuk dha dorëheqjen, pasi ishte vërtetuar tashmë se ky gjykim ishte me objekt të ndryshëm nga tjetri.

18. Gjykata thekson se vlerësimi i dhënies ose jo të dorëheqjes së gjyqtarit nga gjykimi i një çështjeje, është në vlerësimin e vetë gjyqtarit, i cili çmon nëse ekzistojnë rrethanat të tilla që mund të kompromentojnë gjykimin e tij në një çështje të caktuar. Në rastin konkret, pavarësisht sjelljes së gjyqtarës M.R., e cila ka çmuar se nuk ndodhet në kushtet e dhënies së dorëheqjes, kërkuësja ka pasur mundësi të kërkojë përjashtimin e saj nga gjykimi, gjë e cila nuk është bërë. Në këtë mënyrë, kërkuësja nuk arriti të provojë pretendimin për anshmëri të trupit gjykues para kësaj Gjykate.

19. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se pretendimi për anshmëri të trupit gjykues gjatë gjykimit në Gjykatën e Apelit Vlorë, nuk është i bazuar.

C. Mbi të drejtën për t'u dëgjuar në Gjykatën e Lartë

20. Kërkuësja pretendon se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, edhe pse nga ajo janë pretenduar shkelje të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor nga gjykatat më të ulëta, si dhe shkaqe (shkelje procedurale) të parashikuara nga neni 472 i KPC-së.

21. Gjykata, në jurisprudencën e saj të vazhdueshme, ka theksuar se Kolegji i Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, është organi që analizon dhe vlerëson nëse shkaqet e ngritura në rekurs janë në përputhje me kërkesat e ligjit, duke vlerësuar kështu nëse rekursi përmban shkaqe për t'u kaluar për shqyrtim në seancë gjyqësore. Si për pranimin, ashtu edhe për mospranimin e rekursit, dhoma e këshillimit, nëpërmjet arsytimit të vendimeve të saj, luan rolin e një filtri seleksionues të kërkesave që i drejtohen Gjykatës së Lartë.

22. Sigurisht që palët përpara kësaj trupe gjyqësore, në një numër të madh rastesh, *prima facie* i plotësojnë formalisht kriteret që kërkesa e tyre të shkojë në seancë publike, por kjo nuk mund t'ia deformojë funksionin vlerësues dhomës së këshillimit. Në rast se Kolegji, në dhomën e këshillimit, krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs objektivisht nuk gjejnë mbështetje në aktet e administruara në dosjen gjyqësore, atëherë është në kompetencën e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore (*shih vendimet nr. 22/2011; nr. 36/2011; nr. 19/2013, të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Duke iu referuar rastit konkret, Kolegji Civil, në dhomë këshillimi, ka vlerësuar pretendimet e kërkuases në dritën e fakteve të pasqyruara në dosje. Për këtë arsye, ai ka çmuar se nuk ka shkaqe për t'i shqyrtuar në seancë. Në vështrim të sa më lart, Gjykata vlerëson se procesi në dhomën e këshillimit nuk ka cenuar të drejtën për t'u dëgjuar të kërkuases dhe si i tillë nuk është rrjedhojë e një procesi të parregullt ligjor, në kuptim të nenit 42/2 të Kushtetutës.

24. Në përfundim, Gjykata konstaton se në çështjen objekt shqyrtimi nuk ndodhemi para cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6/1 i KEDNJ-së.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja "f", dhe nenit 134, pika 1, shkronja "g" të Kushtetutës; nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

VENDOSI:

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Gani Dizdari, Besnik Imeraj

VENDIM

Nr. 16, datë 21.3.2014

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

| | | | |
|-----------------|--------------------------------|---|---|
| Bashkim Dedja | kryetar i Gjykatës Kushtetuese | | |
| Vladimir Kristo | anëtar i | " | " |
| Sokol Berberi | anëtar i | " | " |
| Vitore Tusha | anëtar e | " | " |
| Altina Xhoxhaj | anëtar e | " | " |
| Fatmir Hoxha | anëtar i | " | " |
| Besnik Imeraj | anëtar i | " | " |
| Fatos Lulo | anëtar i | " | " |
| Gani Dizdari | anëtar i | " | " |

me sekretare Blerina Basha, në datat 26.9.2013, 17.10.2013 dhe 7.11.2013, mori në shqyrtim mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 32/5 Akti, që i përket:

KËRKUES: Nazmi Luku.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Ministria e Transportit dhe e Infrastrukturës, shoqëria e përmbartimit "EPSA" sh.p.k.

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 81, datë 18.6.2008, të Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda një afati të arsyeshem.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, pika 1, 131, shkronja "f", dhe 134, pika 1, shkronja "g" të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6 dhe 41 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut; nenet 28, 29, 30, 45 dhe 77 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë".

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Gani Dizdari, shqyrtoi parashtrimet e kërkuessit, që kërkoi pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, që kërkoi rrëzimin e kërkesës, dhe shoqërisë përmbartimore ESPA sh.p.k. që kërkoi pranimin e kërkesës, si dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuessi ka punuar "Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme pranë Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës (ish-Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, më poshtë Ministria) për një periudhë 10-vjeçare.

2. Me vendimin nr. 25/9 Prot., datë 25.9.2007, Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimeve Mbështetëse ka

marrë ndaj kërkuesit masën disiplinore *“Largim nga shërbimi civil”*. Kërkuesi e ka ankimuar këtë vendim në Komisionin e Shërbimit Civil (KSHC), i cili me vendimin nr. 38, datë 6.2.2008, vendosi: *“Shfuqizimin e aktit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimeve Mbështetëse. Kthimin e ankuesit në vendin e mëparshëm të punës si Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse në Drejtorinë e Shërbimeve Brendshme. Detyrimin e institucionit për të bërë pagesën që nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënies financiare deri në zbatim të këtij vendimi.”*

3. Mbi ankimin e Ministrisë, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin 81, datë 18.6.2008, vendosi: *“Lënien në fuqi të vendimit nr. 38, datë 6.2.2008 të Komisionit të Shërbimit Civil.”*

Mbi rekursin e Ministrisë, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 862, datë 9.7.2010, vendosi: *“Mospranimin e rekursit”*.

4. Kërkuesi i është drejtuar Departamentit të Administratës Publike më datë 18.10.2010, duke i kërkuar zbatimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, nr. 81, datë 18.6.2008, të Gjykatës së Apelit Tiranë.

5. Departamenti i Administratës Publike (DAP), me shkresën nr. 1913/1 Prot., datë 25.10.2010, i ka kërkuar Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë zbatimin e vendimit të formës së prerë. Nga Ministria nuk ka pasur reagim.

6. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Apelit Tiranë për lëshimin e urdhrin ekzekutiv për zbatimin e vendimit nr. 81, datë 18.6.2010. Gjykata e Apelit, me vendimin nr. 117, datë 1.12.2010, lëshoi urdhrin ekzekutiv për këtë qëllim.

7. Më datë 17.12.2010 kërkuesi i është drejtuar shoqërisë përmbarimore private EPSA sh.p.k. për ekzekutimin e urdhrin të ekzekutimit nr. 117, datë 1.12.2010, të Gjykatës së Apelit, me qëllim zbatimin e vendimit nr. 81, datë 18.6.2008, të po asaj Gjykate. Përmbaruesi, me shkresën nr. 304, datë 20.12.2010, bëri lajmërimin për ekzekutimin vullnetar, nga ana e Ministrisë, të urdhrin të ekzekutimit dhe me shkresën nr. 70 Prot, datë 3.1.2011, ai iu drejtua bankave të nivelit të dytë për vendosjen e masës sekuestro konservative në llogaritë bankare të debitorit (Ministrisë) për shumën e detyrimit prej 3 336 499 lekësh. Më tej, përmbaruesi i ka dërguar debitorit shkresën nr. 71 Prot, datë 5.1.2011, për ta njoftuar lidhur me ekzekutimin e detyrueshëm të urdhrin ekzekutiv, pas së cilës nuk u veprua sërish nga pala debitore. Përmbaruesi i ka dërguar shkresë Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë, me të cilën njoftohet se do të gjobitet për refuzim të zbatimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, si dhe do të kallëzohet për ndjekje penale.

8. Pala debitore, Ministria, ka bërë kundërshtim të veprimeve përmbarimore me pretendimin se ndodhej

para provave të reja. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 4008, datë 16.5.2011, ka rrëzuar padinë duke e gjetur të pabazuar. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1581, datë 20.6.2012.

9. Përmbaruesi, pas refuzimit të vazhdueshëm të Sekretarit të Përgjithshëm për të zbatuar vendimin gjyqësor, ka aplikuar masën e gjobës prej 50.000 lekësh ndaj tij. Gjithashtu, përmbaruesi, me shkresën nr. 3441, datë 20.5.2011, ka urdhëruar sektorin përgjegjës të financës pranë Ministrisë të ndalojë nga paga e Sekretarit të Përgjithshëm shumën prej 50.000 lekësh.

10. Në datë 24.11.2011 përmbaruesi ka nxjerrë shkresën nr. 8371 Prot., me anë të së cilës ka urdhëruar Degën e Thesarit Tiranë për vendosjen e sekuestros konservative në llogarinë e Ministrisë në shumën prej 3,972,122 (detyrimi prej 3,764,331 ndaj kërkuesit plus tarifa përmbarimore në masën prej 207,7961 lekë).

11. Pas vendosjes së sekuestros konservative, debitori i ka paguar kreditorit shumën prej 1 053 609 lekësh, gjë që vërtetohet me çekun nr. 00319175, datë 29.12.2011. Më datë 4.4.2012 ndaj kërkuesit është bërë një pagesë tjetër prej 100 800 lekësh. Veprim tjetër për bërjen e pagesës ose të kthimit në punë nuk ka pasur.

12. Përmbaruesi dhe kërkuesi, pas këtyre veprimeve, i janë drejtuar disa herë Ministrisë (më datë 6.2.2012; 21.6.2012; 16.10.2012; 22.11.2012; 11.2.2013; 11.4.2013), por nuk ka pasur asnjë reagim nga pala debitore.

II

13. **Kërkuesi** pretendon se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, pasi nuk po realizon të drejtën e tij të fituar gjyqësisht si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nga institucionet shtetërore.

14. **Subjekti i interesuar**, Ministria e Transportit dhe e Infrastrukturës, ka parashtruar se ka qenë në pamundësi të zbatojë vendimin gjyqësor të formës së prerë për pjesën e kthimit të kërkuesit në vendin e punës, pasi kërkesat për këtë pozicion pune kanë ndryshuar. Sa i takon shlyerjes së detyrimit financiar, sipas subjektit të interesuar, ai është shlyer në masën 33% të shumës (në dhjetor të vitit 2011) dhe më pas edhe 5.34% të saj (në mars të vitit 2012). Pritet që në bazë të fondeve të akorduara nga buxheti i shtetit për vitin në vijim të shihet mundësia e shlyerjes sa më parë të detyrimit të mbetur ndaj kërkuesit.

15. **Subjekti i interesuar**, shoqëria përmbarimore “EPSA” sh.p.k., ka paraqitur të gjitha dokumentet shkresore që vërtetojnë veprimet e kryera prej saj konkretisht lidhur me ekzekutimin e detyrimit që rrjedh nga vendimi gjyqësor i formës së prerë, në fund të të cilave sërish nuk është arritur ekzekutimi i të gjithë detyrimit ndaj kërkuesit.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Mbi zëvendësimin procedural të subjektit të interesuar

16. Kërkuesi, mbështetur në nenin 1/2 të ligjit nr. 8755, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", si dhe në nenin 199/2 të Kodit të Procedurës Civile, ka paraqitur një kërkesë ku kërkon kalimin procedural të subjektit të interesuar, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, dhe thirrjen në gjykim si subjekt i interesuar të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, pasi ajo strukturë nuk ekziston më sipas dekretit nr. 8304, datë 11.9.2013 të Presidentit të Republikës.

17. Gjykata, me qëllim zhvillimin e një procesi të rregullt me ndërhyrje të përcaktuara qartë, e pa të nevojshëm saktësimin e faktit se në varësi të cilës Ministri ka kaluar kjo drejtori dhe bashkë me të edhe të drejtat dhe detyrimet e subjektit debitor, me qëllim kalimin procedural sipas kërkesës së parashtruar nga kërkuesi. Me shkresën nr. 521/1 Prot., datë 4.11.2013, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës njofton Gjykatën se Drejtorja e Shërbimeve të Brendshme është në vartësi të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës. Mbi këtë bazë, Gjykata vendosi: "Kalimin procedural dhe marrjen pjesë në cilësinë e subjektit të interesuar Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës në vend të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit."

B. Mbi pretendimin për mosekzekutim të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm

18. Gjykata ka theksuar se ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i vendimit të formës së prerë të gjykatës, duhet konsideruar si pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë. Çdo organ shtetëror detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë (*shih vendimet nr. 35, datë 27.10.2010; nr. 23, datë 17.5.2010; nr. 1, datë 19.1.2009, të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individi e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Procesi i vendosjes në vend të një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave, por edhe veprimet konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara

me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

20. Gjykata ka rikonfirmuar qëndrimin se në një çështje që përfshin përcaktimin e një të drejte civile, kohëzgjatja e procedurave normalisht llogaritet nga momenti i fillimit të procedurës gjyqësore deri në momentin kur jepet vendimi dhe ekzekutohet ai. Faza ekzekutive konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtit proces. Sipas saj, kohëzgjatja e arsyeshme e procedimeve duhet të vlerësohet në dritën e rrethanave të çështjes dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen dhe interesin e kërkuesit dhe autoriteteve përkatëse. Për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara, volumin e provave shkresore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme (*shih vendimet nr. 14, datë 15.4.2010; nr. 8, datë 23.3.2010; nr. 9, datë 1.4.2009; nr. 1, datë 19.1.2009, të Gjykatës Kushtetuese*).

i) Kompleksiteti i çështjes

21. Në lidhje me detyrimin për rikthimin e kërkuesit në vendin e mëparshëm të punës, rezulton se nga pikëpamja ligjore dhe faktike dispozitivi i vendimit nr. 81, datë 18.6.2008, të Gjykatës së Apelit Tiranë nuk paraqet vështirësi në ekzekutim, pasi në rastin konkret kemi të bëjmë me një vendim i cili ka shfuqizuar një akt administrativ që rregullon marrëdhëniet e punës në bazë të ligjit "Për statusin e nëpunësit civil". Për rivendosjen e të drejtës së kërkuesit nevojitet nxjerrja e një akti të titullarit të institucionit për rikthimin e kërkuesit në vendin e mëparshëm të punës ose marrjen e masave për të gjetur një zgjidhje tjetër sa më të përshtatshme, në kuadër të dispozitivit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

22. Në lidhje me detyrimin për pagimin e pagave nga data e ndërprerjes së marrëdhënieve financiare deri në ekzekutimin e plotë të vendimit, Gjykata çmon se edhe ky detyrim është i identifikueshëm nga pikëpamja faktike dhe juridike. Kështu, paga e kërkuesit në momentin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës ka qenë e përcaktuar qartë. Pagat për nëpunësit e shërbimit civil janë përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, në bazë të pozicionit të punës dhe, posaçërisht, pozicionit të përgjegjës të sektorit të shërbimeve i përgjigjet pagesa e kategorisë III a/1.

23. Po kështu, edhe dispozitivi i vendimit të KSHC-së, i lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë, është i qartë dhe i përcaktueshëm, pasi detyron debitorin që t'i paguajë pagën kërkuesit deri në momentin e ekzekutimit të vendimit. Në lidhje më këtë pikë, pra me përcaktueshmërinë e detyrimeve financiare të debitorit

kundrejt kreditorit në marrëdhëniet që lindin në shërbimin civil, Gjykata nuk sheh ndonjë paqartësi në dispozitivin e vendimit të formës së prerë. Fakti që janë kryer disa pagesa të pjesshme nga debitori është tregues se edhe ekzekutimi i këtij detyrimi nuk paraqet vështirësi.

24. Nga sa më lart, Gjykata çmon se çështja konkrete nuk paraqet rrethana të veçanta që mund të justifikojnë vonesën në ekzekutimin e vendimit të formës së prerë nr. 81, datë 18.6.2008, të Gjykatës së Apelit Tiranë, nga dita e marrjes së tij deri në realizimin e plotë të detyrimit ndaj kërkuesit.

ii) Sjellja e kërkuesit

25. Kohëzgjatja e arsyeshme e procedimit të çështjes është vlerësuar nga Gjykata si thelbësore për të përcaktuar nëse ndodhemi para rastit të tejkalimit të afateve të arsyeshme. Ky element lidhet me mosekzekutimin e vendimeve të formës së prerë për faj të veprimeve apo mosveprimeve të kërkuesit, duke sjellë tejkalimin e një afati të arsyeshëm për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

26. Në rastin konkret, sjella e kërkuesit përcaktohet nga qëndrimi i tij gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit. Konkretisht, kërkuesi, pas marrjes formë të prerë të vendimi nr. 81 datë 18.6.2008, të Gjykatës së Apelit Tiranë, i është drejtuar debitorit me një kërkesë, ku i ka kërkuar zbatimin e këtij vendimi. Kjo kërkesë u refuzua me arsyetimin se ai (debitori) kishte bërë rekurs në Gjykatën e Lartë dhe, për rrjedhojë, vendimi konsiderohet i pezulluar.

27. Pas vendimit të mospranimit të rekursit nga Gjykata e Lartë marrë me datë 18.10.2010, kërkuesi, në datën 15.11.2010, i është drejtuar Departamentit të Administratës Publike duke i kërkuar ekzekutimin e vendimit gjyqësor.

28. Gjithashtu, më datë 17.12.2010, kërkuesi ka kontraktuar një shoqëri përmbaruese private për ekzekutimin e urdhrin të ekzekutimit nr. 117 datë 1.12.2010, lëshuar për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë nr. 81 date 18.6.2008, të Gjykatës së Apelit. Gjatë gjithë kohës së fazës së ekzekutimit të vendimit gjyqësor nga ana e shoqërisë përmbaruese, kërkuesi ka vijuar t'i paraqesë kërkesa të njëpasnjëshme debitorit.

29. Nga të gjitha këto veprime, Gjykata arrin në përfundimin se kërkuesi jo vetëm nuk është bërë pengesë për realizimin e procesit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, por ai ka shfaqur interes të vazhdueshëm për ekzekutimin e tij të plotë.

30. Sa më sipër, Gjykata çmon se kërkuesi ka vepruar në përputhje me të drejtat e tij procedurale, duke shteruar mjetet ligjore në dispozicion të tij për rivendosjen e së drejtës së cenuar.

iii) Sjellja e autoriteteve

31. Gjykata në jurisprudencën e saj është shprehur se i takon debitorit të gjejë një mundësi zgjidhjeje sa më të përshtatshme me qëllim vënien në vend të së drejtës së kreditorit. Autoritetet shtetërore nuk mund të justifikohen me pamundësinë për të mos respektuar një detyrim që vjen nga një vendim gjyqësor, por duhet të përpiqen me të gjitha mjetet dhe mundësitë që kanë në dispozicion për ta zbatuar atë (*shih vendimet nr. 4, datë 20.2.2013; nr. 10, datë 1.3.2012 dhe nr. 2, datë 1.2.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Më tej, Gjykata është shprehur se... "*përballë detyrimit për zbatim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të gjitha subjektet, qofshin këto private apo publike, duhet të përgjigjen njëjloj*" (*shih vendimet nr. 7, datë 27.2.2012; nr. 35, datë 27.10.2010; nr. 23, datë 17.5.2010 dhe nr. 1, datë 19.1.2009, nr. 20, datë 29.4.2013, të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Në rastin konkret, debitori, Ministria, në çdo rast ka mbajtur qëndrim refuzues në lidhje me ekzekutimin e vendimit të formës së prerë. Në lidhje me detyrimin për rikthimin në punë, debitori ka shfaqur gjithmonë refuzimin e tij dhe nuk ka marrë asnjë masë për ekzekutim. Kështu, me shkresën nr. 5682/1, datë 28.8.2008, ai ka refuzuar ekzekutimin e vendimit të Gjykatës së Apelit nr. 81, datë 18.6.2008, me arsyetimin se ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë dhe deri në shqyrtimin e tij vendimi i Gjykatës së Apelit nuk mund të ekzekutohet.

33. Lidhur me këtë argument të përdorur nga Ministria, Gjykata vazhdimisht ka theksuar se "*Në përputhje me parashikimet e nenit 449 dhe 451 të KPC-së, vendimi i gjykatës së apelit është i formës së prerë dhe ushtrimi i rekursit ndaj tij pranë Gjykatës së Lartë nuk ka efekt pezullues, me përjashtim të rasteve kur kjo e fundit vendos pezullimin e vendimit të rekursuar, në bazë të nenit 479 të KPC-së.*" (*vendimi nr. 56, datë 21.12.2012 i Gjykatës Kushtetuese*). Më tej, po në këtë vendim, Gjykata është shprehur se "*...një personi, që pajiset me një vendim të ekzekutueshëm kundër shtetit në favorin e tij, nuk mund t'i kërkohej t'u drejtohet organeve përmbarimore për të ekzekutuar vendimin*". Pra, me dhënien e vendimit nga Gjykata e Apelit, debitori duhej të merrte masa të menjëhershme për ekzekutimin e vendimit të kësaj gjykate, pasi ekzekutimi nuk kushtëzohet as me ankimin në Gjykatën e Lartë, as me bërjen e kërkesës në organet përmbarimore.

34. Gjykata vlerëson se edhe argumenti tjetër i debitorit se ekzekutimi i vendimit është i pamundur, pasi për atë vend pune që ka pasur kërkuesi kanë ndryshuar kriteret lidhur me arsimin e nevojshëm që duhet të ketë i punësuar në këtë pozicion, është i pabazuar. Ky argument është hedhur poshtë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendim i cili është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë. Gjykata rithekson se është

detyrimi i debitorit që në këtë rast të gjejë mundësitë e duhura për të kthyer në punë kërkuesin, si detyrim që rrjedh nga vendimi gjyqësor i formës së prerë.

35. Në lidhje me detyrimin e dytë, atë të kryerjes së pagesës, Gjykata vëren se deri në ditën e zhvillimit të seancës gjyqësore janë bërë vetëm dy pagesa të pjesshme. Pra, debitori ka treguar se e pranon këtë detyrim, por megjithatë masat e marra prej tij për realizimin e të gjithë detyrimit janë të pamjaftueshme. Rezulton se nga dita e kryerjes së pagesës së fundit ka kaluar më tepër se një vit dhe debitori nuk po shfaq angazhimin e duhur për ekzekutimin e pjesës së mbetur të detyrimit.

36. Nisur nga ky fakt, Gjykata thekson se pavarësisht se fondi i përcaktuar nga buxheti mund të mos jetë i mjaftueshëm për të shlyer të gjithë detyrimin, debitori duhet të tregojë vullnetin e tij për të shlyer sa më parë diferencën e mbetur të detyrimit ndaj kreditorit. Duke qenë se vendimi i formës së prerë përmban detyrimin për t'i paguar pagën kërkuesit deri në ditën e ekzekutimit të vendimit, shuma që mbetet për t'u shlyer vazhdon të shtohet për çdo ditë/muaj vonesë në shlyerjen e tij. Në këtë kuptim, detyrimi i debitorit nuk vjen duke u zvogëluar nëse ai shtyn në kohë ekzekutimin, përkundrazi, ai shtohet. Debitori në këtë rast duhet të mbajë parasysh jo vetëm detyrimin që ka ndaj kreditorit, por edhe interesin publik në administrimin e mirë të buxhetit të shtetit për të mos i shkaktuar atij dëme financiare. Në këtë kuptim, një realizim i plotë i detyrimit është jo vetëm në favor të kreditorit për të realizuar të drejtën e tij të fituar nga një vendim gjyqësor, por i shërben edhe administrimit sa më të mirë të të ardhurave të taksapaguesve.

37. Sa i takon sjelljes së përmbarusit gjyqësor, si autoritet i ngarkuar nga ligji për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, Gjykata vëren se ai ka kryer disa veprime të nevojshme për ekzekutimin e vendimit gjyqësor. Kështu, ai i është drejtuar debitorit me shkresa të njëpasnjëshme dhe gjithashtu ka marrë masën e sekuestros konservative me qëllim ekzekutimin e këtyre vendimeve. Për këtë qëllim, ai ka nxjerrë një numër shkresash, si lajmërimet për ekzekutim vullnetar, për ekzekutimin e detyrueshëm, urdhrat për vendosjen e sekuestrove, kërkesa për përmbushjen e detyrimit, gjoba të ndryshme dhe një sërë shkresash të tjera bashkëlidhur dosjes, duke marrë të gjitha masat e nevojshme ligjore për ekzekutimin e vendimit gjyqësor.

38. Lidhur me afatet kohore, në çështjen konkrete rezulton se urdhri i ekzekutimit mban datën 1.12.2010. Gjykata çmon se *prima facie* rezulton të jetë një afat i tejzgjatur kohor, nisur nga tërësia e rrethanave të çështjes, dhe se debitori ka pasur kohën e mjaftueshme në dispozicion për të ekzekutuar detyrimin ndaj

kërkuesit. Ai jo vetëm që nuk e ka bërë këtë, por vazhdon të shprehet se nuk do të kryejë veprimet e duhura në plotësim të detyrimeve të tij ndaj kreditorit duke përdorur argumente, të tilla si: kriteret e reja për vendin e punës apo mungesën e fondeve të buxhetit për këtë qëllim.

39. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit është i bazuar dhe duhet pranuar, pasi si rrjedhojë e mosekzekutimit nga autoritetet e ngarkuara nga ligji dhe brenda një afati të arsyeshëm të vendimit gjyqësor të formës së prerë, atij i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, e parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6/1 i KEDNJ-së.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja "f", dhe nenit 134, pika 1, shkronja "g" të Kushtetutës; nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

VENDOSI:

Pranimin e kërkesës.

Konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 81, datë 18.6.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Gani Dizdari, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

VENDIM

Nr. 17, datë 24.3.2014

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

| | | | |
|-----------------|--------------------------------|---|---|
| Bashkim Dedja | kryetar i Gjykatës Kushtetuese | | |
| Vladimir Kristo | anëtar i | " | " |
| Sokol Berberi | anëtar i | " | " |
| Vitore Tusha | anëtar e | " | " |
| Fatmir Hoxha | anëtar i | " | " |
| Altina Xhoxhaj | anëtar e | " | " |

me sekretare Brunilda Bara, në datat 31.10.2013, 5.12.2013 dhe 14.1.2014 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë dokumentesh çështjen me nr. 36/9 Akti, që i përket palëve:

KËRKUES: Rajmond Toptani, Marion Toptani, Edward Toptani

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Rea Merepeza
Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë
OBJEKTI: Shfuqizimi, si i papajtueshëm me
Kushtetutën, i vendimit nr. 00-2012-2676, datë 21.12.2012,
të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f dhe 134/1/g, të
Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Altina Xhoxhaj,
shqyrtoi dokumentet e paraqitura dhe pasi bisedoi çështjen
në tërësi,

VËREN:

I

1. Me vendimin nr. 828, datë 8.4.1996 të Komisionit të
Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP) Tiranë,
subjektit të shpronësuar Mehmet Ali dhe Ferdin Toptani,
trashëgimtarë të Zija dhe Sadete Toptanit, u është njohur
pronësia mbi një sipërfaqe trualli prej 6724 m² dhe objekte,
duke u kthyer si i lirë trualli prej 5000 m² dhe shtëpia mbi
të.

2. Këtë pasuri, shtetasi Zija Toptani ia kishte shitur
gruas së tij Sadete dhe kjo e fundit ia kishte dhuruar
djemve të saj të mitur Mehmet Ali dhe Ferdin Toptani, të
cilët i kanë regjistruar këto veprime në regjistrat
përkatës të hipotekave të kohës (viti 1936).

3. Shtetasi Zija Toptani ka qenë i martuar edhe më
parë, martesë nga e cila ka pasur disa fëmijë, të cilët kanë
qenë madhorë në momentin e vdekjes së Sadete dhe Zija
Toptanit.

4. Në vitin 1996, shtetasja Rea Merepeza, trashëgimtare
e fëmijëve nga martesa e parë e Zija Toptanit, ka ngritur
padi për kundërshtimin e vendimit nr. 828, datë 8.4.1996,
të KKKP-së Tiranë, dhe ka kërkuar që prona t'u kthehet të
gjithë trashëgimtarëve të Zija Toptanit, sipas dëshmimeve
përkatëse të trashëgimisë.

5. Në atë gjykim, ajo ka paraqitur në cilësinë e
provës aktgjykimin nr. 130, datë 15.11.1942, të
Gjykatës së Tiranës, ku në dispozitiv janë deklaruar të
pavlefshme të gjitha shitjet "fiktive" të Zija Toptanit për
gruan e tij Sadete dhe fëmijët nga martesa e dytë.

6. Me vendimin nr. 9955, datë 17.12.1996, Gjykata
e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur pranimin e padisë
së shtetasës Rea Merepeza, duke disponuar njohjen e të
drejtave të pronësisë në vendimin nr. 828, datë 8.4.1996
të KKKP-së Tiranë për të gjithë trashëgimtarët e Zija
Toptanit. Ky vendim ka marrë formë të prerë.

7. Në vitin 2002, trashëgimtarët Toptani i janë drejtuar
gjykatës me padi, me objekt deklarimin të falsifikuar të
dokumentit "akt gjykimi" të vitit 1942, mbi bazën e të cilit
subjekti i interesuar Rea Merepeza është njohur
bashkëpronare mbi pasuritë objekt konflikti gjyqësor. Mbi
bazën e provave të administruara në atë gjykim, me
vendimin nr. 4068, datë 21.10.2002, Gjykata e Rrethit

Gjyqësor Tiranë ka vendosur pranimin e padisë, duke e
shpallur të falsifikuar shkresën "*akt gjykimi nr. 421 i aktit,
130 i gjykimin, të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, DC të
datës 15.11.1942*".

8. Bazuar në vendimin gjyqësor nr. 4068, datë
21.10.2002, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në
vitin 2006, pra pas afërsisht katër viteve nga lindja e
shkakut të rishikimit, kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës
së Lartë me kërkesë për rishikimin e vendimit gjyqësor
të formës së prerë. Me vendimin nr. 18, datë
18.5.2007, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e
kërkesës, si e paraqitur jashtë afatit ligjor.

9. Kundër këtij vendimi kërkuesit kanë paraqitur
kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, e cila, me vendimin
nr. 55, datë 16.6.2009, ka vendosur moskalimin e
çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

10. Me shkresën e datës 25.2.2009 kërkuesve, në
bazë të kërkesës së tyre, u janë vënë në dispozicion, nga
Arkivi Qendror i Shtetit, një seri dokumentesh arkivore,
në bazë të të cilave ata i janë drejtuar sërish Gjykatës së
Lartë me kërkesën për rishikimin e vendimit gjyqësor të
formës së prerë nr. 9955, datë 17.12.1996, të Gjykatës
së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

11. Me vendimin nr. 00-2012-2676, datë 21.12.2012,
Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin
e kërkesës së paraqitur nga kërkuesit Rajmond Toptani,
Marion Toptani dhe Edward Toptani, për arsye se është
paraqitur jashtë afatit 1-vjeçar nga koha që vendimi ka
marrë formë të prerë.

II

12. *Kërkuesit Rajmond Toptani, Marion Toptani dhe
Edward Toptani*, i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese,
me kërkesë për shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Civil
të Gjykatës së Lartë, për këto arsye:

12.1 Është cenuar e drejta e aksesit në Gjykatën e
Lartë. Kërkesa për rishikim ishte përpiluar në përputhje
të plotë me kërkesat e ligjit si nga ana formale, ashtu
edhe në përmbajtje. Në rastin konkret nuk konstatohet
asnjë nga shkaqet e parashikuara nga neni 498 i Kodit të
Procedurës Civile (KPC) për mospranimin e kërkesës.
Në rastin konkret plotësoheshin të gjitha kriteret ligjore
të parashikuara nga neni 494/a i KPC-së.

12.2 Është cenuar standardi kushtetues i arsyetimit të
vendimeve gjyqësore. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka
vendosur mospranimin e rekursit pa arsyetuar shkaqet që e
kanë çuar në arritjen e një konkluzioni të tillë. Ky vendim,
në pjesën arsyetuese mjaftohet vetëm me përfundimin se
kërkesa e paraqitur është depozituar jashtë afatit 1-vjeçar
nga koha kur vendimi ka marrë formë të prerë, duke iu
referuar vetëm dispozitës së nenit 445 të KPC-së, pa
argumentuar se përse në rastin në fjalë nuk duhen
marrë parasysh afatet e posaçme që ka parashikuar
ligjvënësi në dispozitat e veçanta që lidhen me
kërkesën për rishikim.

12.3 Është cenuar parimi i barazisë së shtetasve para ligjit. Gjykata e Lartë, në çështje analoge, ka mbajtur qëndrime të ndryshme lidhur me kërkesat për rishikimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, për sa i përket trajtimit të afatit të paraqitjes së tyre.

12.4 Duke mos pranuar kërkesën për rishikimin e vendimeve të formës së prerë, Gjykata e Lartë ka cenuar të drejtën e pronës, të garantuar në nenin 41 të Kushtetutës. Kjo pronë (e fituar me dhurim) u është marrë kërkuesve dhe i është dhënë subjektit të interesuar në sajë të një procesi të parregullt, pa asnjë titull dhe mënyrë fitimi, në kundërshtim me nenin 41/2 të Kushtetutës.

12.5 Nëpërmjet institutit të rishikimit, ligjvënësi ka parashikuar mundësinë e rivendosjes së një të drejte të cenuar, kurse interpretimi që Gjykata e Lartë i ka bërë dispozitës në rastin konkret është kufizues, duke sjellë si pasojë cenimin e të drejtës së pronës. Si pasojë e mospranimit të kërkesës për rishikim, një vendim gjyqësor, i bazuar në dokumente të falsifikuara dhe të asgjësuar, ekziston në qarkullimin civil si një titull ekzekutiv i pacenuar.

13. *Shtetasi Zija Vrioni*, me kërkesën e datës 4.12.2013, ka kërkuar që të marrë pjesë në këtë gjykim në cilësinë e subjektit të interesuar. Në seancën e datës 5.12.2013 Gjykata vendosi rrëzimin e kësaj kërkesë, pasi ky subjekt nuk ka qenë palë në procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë, objekt i këtij gjykimi.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Lidhur me legjitimitimin e kërkuesve për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese

14. Bazuar në nenin 131/f të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese (Gjykata) vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individit për shkeljen e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi ai të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e kësaj të drejte. Gjykata ka theksuar se juridiksioni kushtetues për shkeljen e së drejtës themelore për një proces të rregullt bëhet i mundur kur kërkuesi shteron mjetet e ankimit pranë gjykatave të sistemit gjyqësor, çka nënkupton që kërkuesi duhet t'i shfrytëzojë, në shkallët e sistemit gjyqësor, të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të së drejtës të pretenduar. Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet nr. 17, datë 18.7.2005; nr. 1, datë 25.1.2010; nr. 17, datë 16.5.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në këtë kuptim, Gjykata ka vlerësuar se në rastet kur kundërshtohet procesi i rishikimit i zhvilluar në Gjykatën e Lartë, për vetë specifikën e këtij lloji gjykimi, duke qenë se rishikimi është mjet i

jashtëzakonshëm dhe vendimi i Gjykatës së Lartë është përfundimtar, kërkuesi nuk ka mjet tjetër për të goditur vendimin që ka pranuar kërkesën për rishikim dhe ka vendosur prishjen e vendimeve gjyqësore të formës së prerë (*shih vendimet nr. 17, datë 18.7.2005; nr. 5, datë 26.1.2007; nr. 6, datë 16.2.2007; nr. 38, datë 5.7.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Për sa më sipër, edhe në lidhje me çështjen konkrete në shqyrtim, Gjykata vlerëson se kërkuesit legjitimohen t'i drejtohen asaj, në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës.

B. Lidhur me pretendimin për cenimin e të drejtës së aksesit

17. Kërkuesit kanë pretenduar cenimin e të drejtës së aksesit në Gjykatën e Lartë, pasi edhe pse kërkesa për rishikim ishte përpiluar në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit si nga ana formale, ashtu edhe në përmbajtje, dhe ajo plotësohte të gjitha kriteret ligjore të parashikuara nga neni 494/a i KPC-së, Gjykata e Lartë nuk e mori atë në shqyrtim. Sipas tyre, në rastin konkret nuk është konstatuar asnjë nga shkaqet e parashikuara nga neni 498 i KPC-së për mospranimin e kërkesës për rishikim.

18. Në jurisprudencën e saj Gjykata është shprehur se e drejta për t'iu drejtuar gjykatës është një nga elementet më të rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ). Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Në këtë këndvështrim, Gjykata ka theksuar se e drejta për t'iu drejtuar gjykatës përbën një garanci për administrimin e mirë të drejtësisë prandaj çdo interpretim i ngushtë i nenit 42 të Kushtetutës dhe i nenit 6 të KEDNJ-së nuk përputhet me qëllimet dhe objektin e këtyre dispozitave (*shih vendimet nr. 14, datë 3.6.2009; nr. 41, datë 28.9.2011; nr. 21, datë 29.4.2013, të Gjykatës Kushtetuese*). Administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. E drejta për t'iu drejtuar gjykatës është një nga aspektet e të drejtës për gjykim, e sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës. Mohimi i të drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 7, datë 11.3.2008; nr. 14, datë 3.6.2009, të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se interpretimi i ligjit procedural është atribut i gjykatave të sistemit

gjyqësor dhe i organeve që e zbatojnë atë. Nisur nga ky parim, edhe sqarimi i kuptimit të çdo dispozite të KPC-së dhe raporti i saj me dispozitat e tjera të përafërta me të për zbatimin e tyre në gjykimet e çështjeve është në kompetencë të gjykatave të sistemit gjyqësor. Megjithatë, problemet e interpretimit dhe zbatimit të ligjit mund të merren në konsideratë prej kësaj Gjykate, por vetëm nëse përmes këtij procesi cenohet e drejta kushtetuese themelore për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 20, datë 29.9.2008, të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Kërkesa për rishikim përfaqëson një formë të veçantë ankimi, një mjet të jashtëzakonshëm, me anë të të cilit kërkohet rishikimi i një vendimi të formës së prerë të gjykatës. Nëpërmjet këtij mjete ankimi mund të hapet një gjykim i mbyllur në mënyrë përfundimtare nga gjykata. Kërkesa për rishikim ushtrohet për shkaqe që qëndrojnë jashtë procesit të themelit, që do të thotë për fakte, prova, rrethana ose ngjarje për të cilat pala nuk kishte dijeni, nuk kishin ndodhur ose nuk ishin vërtetuar gjatë procesit gjyqësor dhe që kanë ndikuar në dhënien e vendimit në fjalë. Duke qenë një mjet i jashtëzakonshëm, pasi ka për objekt një vendim gjyqësor të formës së prerë, me autoritetin e gjësë së gjykuar, pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi gjyqësor vetëm për një numër të kufizuar shkaqesh, të parashikuara shprehimisht nga dispozitat procedurale përkatëse (neni 494 i KPC-së) (*shih vendimin nr. 36, datë 26.7.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Për sa i përket afatit të paraqitjes së kërkesës për rishikim, neni 445³ i KPC-së, në fuqi në momentin e shqyrtimit të kërkesës në Gjykatën e Lartë, parashikonte se: *“Ankimi në gjykatën e apelit, rekursi në Gjykatën e Lartë dhe rishikimi nuk mund të bëhen pasi ka kaluar një vit nga shpallja e vendimit”*, kurse neni 496 i KPC-së parashikon se: *“kërkesa për rishikim mund të paraqitet brenda 30 ditëve nga dita që pala ka marrë dijeni për shkakun e rishikimit, por në çdo rast jo më vonë se një vit nga dita që ka lindur shkakun i rishikimit.”*

22. Gjykata është ndalur edhe më parë, në jurisprudencën e saj, në ballafaqimin e përmbajtjes së nenit 445 të KPC-së dhe të dispozitave që rregullojnë institutin e rishikimit (nenet 494-498 të KPC-së),

³ Me ligjin nr. 122/2013, datë 18.4.2013, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë””, kjo dispozitë është ndryshuar si vijon: *“Ankimi në gjykatën e apelit dhe rekursi në Gjykatën e Lartë nuk mund të bëhen pasi ka kaluar një vit nga shpallja e vendimit. Kjo dispozitë nuk zbatohet kur pala në mungesë vërteton se nuk ka qenë në dijeni të procesit gjyqësor për shkak të pavlefshmërisë së njoftimeve.”*

veçanërisht me përmbajtjen e nenit 496 të këtij Kodi. Gjykata ka theksuar se këto dy dispozita dallojnë nga njëra tjetra sepse:

i) neni 445 sanksionon prekluzivitetin (afatin) e ankimit si mjet procedural për të gjitha llojet e ankimit përfshirë dhe kërkesën për rishikim, duke pasur parasysh se zë vend në titullin e parë të pjesës së tretë të Kodit, kurse neni 496 sanksionon afatin ligjor vetëm për sa i përket kërkesës për rishikim që zë vend në titullin e tretë të pjesës së tretë të Kodit;

ii) neni 445 përcakton vetëm ankimin njëvjeçar nga shpallja e vendimit, kurse neni 496 përcakton afatin njëvjeçar që nga dita që ka lindur shkakun i rishikimit;

iii) neni 445 nuk ka si qëllim përcaktimin e afatit për ankim, ndërsa neni 496 saktëson afatin 30-ditor si determinant nga dita që pala ka marrë dijeni për shkakun e rishikimit. Për pasojë, Gjykata ka theksuar se në rastet e paraqitjes së kërkesës për rishikimin e një vendimi të formës së prerë, neni 445 i KPC-së duhet të zbatohet në harmoni me nenin 496 të Kodit, për sa i përket afatit prekluziv njëvjeçar.

23. Për sa i përket afateve për paraqitjen e kërkesës për rishikim, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë vlerësuar se pavarësisht nga shkakun i rishikimit, fillimi i afatit 30-ditor nga dita e marrjes dijeni për të, si dhe i afatit njëvjeçar nga dita që ka lindur shkakun i rishikimit, është i njëjtë për të gjitha rastet që përbëjnë shkak rishikimi të një vendimi gjyqësor të formës së prerë. Këto afate, duke qenë afate prekluzive (dekadence), nuk mund të pezullohen, të ndërpriten apo të rivendosen (*shih vendimin unifikues nr. 8, datë 24.3.2005, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë*).

24. Në lidhje me çështjen konkrete në shqyrtim, nga materialet bashkëlidhur kërkesës rezultoi se kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për rishikimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë, duke e bazuar kërkesën e tyre në shkronjat “a”, “c” dhe “e” të nenit 494 të KPC-së. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, përpara vlerësimit të provave të paraqitura, është ndalur në verifikimin e respektimit të afatit 30-ditor nga marrja dijeni (neni 496 i KPC-së) dhe atij njëvjeçar nga marrja formë të prerë e vendimit që kërkohet të rishikohet (neni 445 i KPC-së), por nuk ka vlerësuar respektimin e një afati tjetër prekluziv, atë njëvjeçar nga momenti i lindjes së shkakut të rishikimit (neni 496 i KPC-së). Në këto rrethana, Kolegji Civil ka vendosur mospranimin e kërkesës për rishikim, në kuptim të nenit 445 të KPC-së.

25. Gjykata vlerëson se në çështjen në shqyrtim, interpretimi i dispozitave procedurale që rregullojnë institutin e rishikimit të një vendimi të formës së prerë, lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me standardet kushtetuese të së drejtës për një proces të rregullt ligjor,

në drejtim të aksesit në gjykatë, ndaj ato mund të bëhen objekt i kontrollit të saj. Gjykata rithekson se në lidhje me kërkesën për rishikim, duke qenë një mjet i jashtëzakonshëm ankimi, ligjvënësi ka parashikuar se ajo mund të paraqitet vetëm për shkaqe specifikesht të përcaktuara në ligj dhe brenda disa afateve ligjore, të ndryshme nga ato që zbatohen për mjetet e zakonshme të ankimit. Kjo sepse ushtrimi i këtij mjeti ankimi lidhet me shkaqe që qëndrojnë jashtë procesit të themelit, të cilat mund të zbulohen rishtaz nga palët dhe që janë të tilla që mund të riçelin një gjykim të mbyllur në mënyrë përfundimtare. Për këto arsye, për shkak se zbulimi i shkaqeve/rrethanave të reja mund të ndodhë në çdo kohë, afati për paraqiten e kësaj kërkesë nuk mund të jetë i lidhur me marrjen formë të prerë të vendimit që kërkohet të rishikohet. Për më tepër, që kërkesa për rishikim mund të ushtrohet vetëm në rast se ankimesi nuk ka një mjet tjetër ankimi, të zakonshëm, në dispozicion, pasi një mjet si ankimi/rekursi përfshin në të, dhe eliminon, çdo mjet tjetër kundërshtimi.

26. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se përmbajtja e nenit 445 të KPC-së mund të lexohet vetëm duke e harmonizuar me përmbajtjen e nenit 496 të KPC-së, pasi një interpretim dhe zbatim i ndryshëm i kësaj dispozite (*stricto sensu*), cenon thelbin e të drejtës për t'iu drejtuar gjykatës. Edhe në çështjen konkrete, neni 445 i KPC-së duhet interpretuar nga Gjykata e Lartë jo në mënyrë të shkëputur, por duke e parë atë në lidhje me nenin 496 të KPC-së që parashikon afatet e posaçme për paraqitjen e kërkesës për rishikim.

27. Si përfundim, Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë, duke vendosur mospranimin e kërkesës për rishikim, u ka cenuar kërkuessve të drejtën e aksesit në gjykatë, si element i të drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës.

C. *Lidhur me pretendimin për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*

28. Kërkuessit kanë pretenduar cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, pasi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit pa arsyetuar shkaqet që e kanë çuar në arritjen e një konkluzioni të tillë. Në vendim nuk është argumentuar se përse në rastin në fjalë nuk duhen marrë parasysh afatet e posaçme që ka parashikuar ligjvënësi për paraqitjen e kërkesës për rishikim.

29. Gjykata, në jurisprudencën e saj, ka përcaktuar disa standarde kushtetuese, të cilat janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerave (*shih vendimet nr. 34 datë 3.10.2007; nr. 34, datë 25.7.2011; nr. 27, datë 24.6.2013, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, e drejta për të pasur akses në gjykatë i garanton individit të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës

dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj, të arsyetuar, për pretendimet e ngritura.

30. Domosdoshmëria e arsyetimit të vendimit gjyqësor është një garanci për procesin e rregullt ligjor. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 142, sanksionon detyrimin e gjykatave të të gjitha niveleve për të arsyetuar vendimet e tyre. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar. Nga ana tjetër, vetëm duke dhënë një vendim të arsyetuar mund të realizohet një kontroll publik i administrimit të drejtësisë. Gjykatat duhet të parashtrajnë në mënyrë të përmbledhur rrethanat e faktit, provat mbi të cilat bazohet vendimi, mënyrën e vlerësimit të këtyre provave, pra të tregojnë me qartësi të mjaftueshme arsyet mbi të cilat mbështesin vendimet e tyre. Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve, në përfundim të gjykimit, përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Ato përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim (*shih vendimet nr. 33, datë 8.12.2005; nr. 23, datë 4.11.2008; nr. 36, datë 26.7.2011, të Gjykatës Kushtetuese*). Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë gjithashtu të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik (*shih vendimet nr. 20, datë 13.4.2012; nr. 38, datë 30.12.2010; nr. 36, datë 25.7.2013; nr. 3, datë 23.1.2014, të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Sidoqoftë, detyrimi për arsyetimin e vendimit gjyqësor nuk mund të interpretohet sikur kërkohet arsyetim i detajuar për çdo pretendim të palëve ndërgjyqësore, por ai varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimin nr. 36, datë 26.7.2011, të Gjykatës Kushtetuese*). Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre (*shih vendimin nr. 3, datë 23.1.2014, të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Në rastin konkret, Gjykata vlerëson se kërkuessit i janë drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë që

kishte njohur bashkëpronarë mbi pasuritë objekt konflikti gjyqësor edhe fëmijët nga martesë e parë e trashëgimlënës. Si bazë për paraqitjen e kërkesës ata kanë paraqitur disa dokumente shkresore të nxjerra nga Arkivi Qendror i Shtetit, të cilat kanë pretenduar se nuk njiheshin prej tyre në momentin e zhvillimit të gjykimit të themelit. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, pa marrë në analizë asnjë nga provat e paraqitura nga kërkesit, ka vlerësuar se kërkesa nuk kishte respektuar afatin ligjor njëvjeçar të parashikuar në nenin 445 të KPC-së.

33. Gjykata ka vlerësuar se dhoma e këshillimit në Gjykatën e Lartë, si për pranimin ashtu edhe për mospranimin e ankimit, nëpërmjet arsytimit të vendimeve të saj luan rolin e një filtri paraeliminuar të këtyre kërkesave. Sigurisht, që palët përpara kësaj trupe gjyqësore, në një numër të madh rastesh *prima facie* i plotësojnë formalisht kriteret që kërkesa e tyre të shkojë në seancë publike, por kjo nuk mund ta deformat funksionin vlerësues të dhomës së këshillimit (*shih vendimin nr. 4, datë 25.2.2009, të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, duke pasur parasysh qëllimin dhe natyrën e këtij mjeti të veçantë ankimi, Gjykata rithekson se mospranimi i kërkesës për rishikim i heq përfundimisht palës mundësinë për rihapjen e procesit gjyqësor. Për këtë arsye është e nevojshme që dhoma e këshillimit të japë një vendim të arsyetuar për shkaqet që e kanë çuar atë në marrjen e një vendimi të tillë dhe se kërkesat e një procesi të rregullt ligjor mund të plotësohen edhe me një arsyetim të kufizuar të këtyre vendimeve (*shih vendimin nr. 36, datë 26.7.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se arsyetimi i bërë nga Gjykata e Lartë në rastin konkret, duke i dhënë një kuptim të ngushtë përmbajtjes së neneve 445 dhe 496 të KPC-së, përveçse ka cenuar të drejtën e kërkesve për akses në gjykatë, nuk ka respektuar as kërkesën për dhënien e një vendimi të arsyetuar për shkaqet e ngritura në kërkesën për rishikim.

35. Për sa më sipër, edhe pretendimi i kërkesve për parregullsinë e procesit ligjor, për shkak të mosarsytimit të vendimit të Kolegjit Civil që ka vendosur mospranimin e kërkesës për rishikim, është i bazuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “f” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g”, të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 dhe 77 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të vendimit nr. 00-2012-2676, datë 21.12.2012, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Altina Xhoxhaj, Fatmir Hoxha
Anëtare kundër: Vitore Tusha

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë)

| | |
|--|------------------|
| | Formati: 61x86/8 |
|--|------------------|

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2014

Çmimi 28 lekë

Adresa: bulevardi "Gjergj Fishta", pas ish-ekspozitës "Shqipëria Sot",
Tel: 04 24 27 005, 04 24 27 006